



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Raporti Vjetor 2017

Rrjeti i Grave të Kosovës

Raporti Vjetor 2017



© Rrjeti i Grave të Kosovës, maj 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar autorët.

Ky raport është publikuar me ndihmë nga Fondacioni Kvinna till Kvinna. Pëmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të Fondacionit Kvinna till Kvinna.

Rrjeti i Grave të Kosovës po synon të kontribuojë në mbrojtje të ambientit, prandaj disa nga kopjet e nevojshme i shtyp në letër të ricikluar në Night Design Studio në Prishtinë.

www.womensnetwork.org



Përmbajtja

LETËR NGA KRYETARI I BORDIT TË RRGK-së.....	8
HYRJJE.....	11
Vizioni ynë.....	11
Misioni ynë.....	11
Strategjia jonë.....	11
Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së.....	12
NGRITJA E KAPACITETEVE TË RRGK.....	13
Është rritur solidariteti mes organizatave të grave në Kosovë.....	13
Është përmirësuar kapaciteti institucional i RrGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit.....	15
Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave.....	39
GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE.....	40
Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore.....	40
Përmirësimi i institucionalizimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor në Kosovë.....	48
PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESHIN SHËNDETËSOR CILËSOR.....	51



Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor.....	51
Më shumë gra të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor.....	54
JETA PA DHUNË ME BAZË GJINORE.....	57
Përmirësohet zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë.....	57
Është përmirësuar ndërgjegjësimi dhe vëmendja në radhët e zyrtarëve dhe qytetarëve lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual.....	60
Hartohen politikat dhe përmirësohen procedurat për trajtimin e ngacmimit seksual.....	61
Përmirësohet mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës.....	62
MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE.....	65
Më shumë gra sigurojnë punësim	65
Më shumë gra kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi.....	67
Përmirësohet shkalla në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivën gjinore dhe është përmirësuar mbikëqyrja nga një perspektivë gjinore në lidhje me politikat dhe programet e BE-së në Kosovë.....	70
VLERËSIMI I PUNËS SË RrGK.....	72



RAPORTI FINANCIAR I RrGK PËR 2017	73
RRETH NESH.....	82
Bordi Drejtues i RrGK.....	82
Bordi Këshillëdhënës i RrGK.....	82
Stafi i RrGK në vitin 2017	83
Hulumtuesit dhe anketuesit e RrGK për një periudhë të shkurtër kohore.....	84
Përkrahësit/et individual/e të RrGGK.....	85
Organizatat Anëtare të RrGK.....	86
Shtojca 1. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës në vitin 2017	98
Shtojca 2. Të arriturat e avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2017	135



LETËR NGA KRYETARI I BORDIT TË RRGK-së

Të dashur/a bashkëaktivistë/e,

Zgjedhja ime si udhëheqës i bordit, konfirmoi edhe njëherë një të vërtetë nga e cila priret Rrjeti i Grave të Kosovës, të vërtetën që organizata jonë është e kujtudo që ka vullnet e që beson në barazi. Po e mbyllim një vit, i cili më shumë se kurrë dëshmon relevancën dhe domosdoshmërinë e punës së Rrjetit.

RrGK na nevojitet neve si aktivistë/e, që në mënyrë konstruktive të shpërfaqim vullnetin tonë, të jemi të bashkuar/a, e që të kemi zë më të fuqishëm që pandalshëm kërkon barazi. Mbi të gjitha, RrGK, i nevojitet rajonit, si shembull i punës së devotshme dhe i përkushtimit për kauza barazitare e për drejtësi. Falë angazhimit të pakusht, Rrjeti tanimë është shndërruar në derë të hapur për të gjitha/ë gratë e burrat që duan t'i bashkohen përpjekjeve për barazi, e çka është më e rëndësishmja, Rrjeti është adresa ku gratë e shtypura dëgjojnë, trajtohen si subjekte, njihen dhe vlerësohen.

Përgjatë 2017-tës, Rrjeti nuk e la mizogjininë të pasfiduar, nuk i la vrasësit e grave të papërmendur, nuk i la dënimet kontraverse të vrasësve e shtypësve të grave të tejkalojnë në heshtje, u bë vazhdimësi e zërave të këtyre grave, duke mos e lënë sistemin patriarkal të fuqizohet. Rrjeti nuk e la rrahjen e vajzave nga të



afërmit e tyre të trajtohet si senzacion i radhës i internetit. Nuk heshti kur gratë u ofenduan, kur potenciali i tyre u nënvlerësua, kur pronat që ju takojnë atyre, iu mohuan e iu rrëmbyen.

Rrjeti, ashtu si në vitet e kaluara, edhe në 2017, haptaz refuzoi të bashkëjetojë me pabarazi, duke e luftuar atë aktivisht. Ne, edhe në 2017, mbajtëm fuqishëm pozicionin kundër shtypjes gjinore, duke problematizuar mungesën e ndëshkimit të merituar ndaj atyre që shtypën. Ne kështu u bëmë pjesë e shkëputjes së zingjirit shtypës dhe vazhduam ta prioritojmë në nivel kombëtar çështjen e barazisë gjinore. Falë punës së Rrjetit dhe grave e burrave që besojnë në barazi, shtypësit nuk mund të ndihen rehat, të paktën jo aq rehat sa janë ndjerë tash e sa kohë.

Përmes udhëve të shumta, si protestat, paraqitjet mediatike, aktiviteti në terren dhe hulumtimi, Rrjeti i Grave të Kosovës vazhdimisht qëndroi një hap para sfidave të panumërta që rezultojnë prej rrënjës së sistemit patriarkal në çdo aspekt të jetës së shoqërisë kosovare. Anipse ky sistem është i rrënjësuar thellë, Rrjeti me vendosmëri u angazhua që ta çrrënjosë atë, duke besuar në potencialin e ndryshimeve pozitive, duke besuar në bashkimin e shoqërisë kosovare.

Kujtimi për aktivisten tonë Dua Dauti-Kadriu, na është motiv.

Sevdije Berisha, Zejnepe Berisha, Diana Kastrati e të gjitha gratë që u vranë e që shtypen padrejtësisht përditë, janë zëri ynë, e ne jemi zëri i tyre. Shyhyrete Berisha është guximi ynë. Ne, sot, më shumë se



kurrë i kujtojmë këto gra, që nuk do heshtin asnjëherë. I kujtojmë gratë, që udhëheqin punën tonë, kërkesën tonë për barazi. Gratë që u shndërruan në përkujtim kolektiv që lufta për barazi nuk heshtet nga vrasjet, dhe se ne fuqishëm do ofrojmë gjithë energjinë tonë, që rastet e shtypjes përgjatë 2017-ës, të mbesin rastet e fundit.

Përzemërsisht,

Besnik Leka



HYRJE

Vizioni ynë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) parasheh që në shtetin e Kosovës gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kenë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni ynë

Misioni i rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RrGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe të shërbimeve.

Strategjia jonë

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e saj, RrGK ka hartuar Strategjinë për periudhën 2015-2018 (të cilën mund ta gjeni në faqen tonë të internetit). Qëllimi i kësaj strategjie është që të drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2014 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, bordi drejtues, partnerët dhe palët tjera relevante. Kjo strategji e RrGK-së është e ndarë në pesë fusha programatike: I) Ngritja e kapaciteteve të RrGK; II) Gratë në politikë dhe vendimarrje; III) Shëndeti i grave; IV) Dhuna në familje dhe trafikimi; dhe V) Fuqizimi ekonomik i grave.



Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së

Çdo vit Rrjeti raporton te anëtarët e veta, te partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport përmban informata lidhur me aktivitetet e RrGK nga 1 janar 2017 deri më 31 dhjetor 2017. Këtë vit, RrGK ka vendosur që ky raport të shtypet vetëm në disa kopje, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e ambientit, përkatësisht drunjëve. Ky raport është i ndarë në pesë pjesë në të cilat përfshihen objektivat afatgjata të rrjetit:

- Ngritja e kapacitetit të programit të RrGK-së;
- Përkrahja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor;
- Zvogëlimi i dhunës në baza gjinore;
- Avancimi i fuqizimit ekonomik të grave.

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2017, lidhur me sedlin nga këto programe. Pjesët e mëposhtme përmbajnë informata lidhur me progresin e arritur drejt çdo rezultati të pritur dhe rezultatit. Gjithashtu, reflekton të arriturat në Strategjinë 2015-2018. Raporti gjithashtu përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve, Bordit të Drejtorëve, Bordit Këshillëdhënës, stafit, praktikantëve, vullnetarëve, anëtareve dhe përfituesve të granteve.



NGRITJA E KAPACITETEVE TË RRGK

Qëllimi kryesor i programit për ngritjen e kapaciteteve të RrGK është që të egzistojë një lëvizje e qëndrueshme e grave në Kosovë. Një indikator që tregon se RrGK ka bërë progres në arritjen e këtij qëllimi është se RrGK deri në përfundim të vitit 2017 ka zbatuar 79% Strategjinë esaj për vitet 2015-2018.

Më tutje, numri i përkrahësve individual të RrGK-së është rritur nga 53 në 59; si dhe vajzat e djemtë kanë ndërmarrë iniciativa për mbështetjen e lëvizjes, duke treguar që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitete që të vazhdojnë këtë lëvizje. RrGK dhe anëtarët e Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë kanë vazhduar të jenë shumë aktive dhe të zëshme edhe gjatë këtijviti.

Në vitin 2017, RrGK kishte qëllimet dhe rezultatet e mëposhtme, të cilat kontribuan në arritjen e këtij programi, siç është paraparë me Strategjinë tonë.

Është rritur solidariteti mes organizatave të grave në Kosovë

Përvoja e RrGK-së tregon që përkrahja dhe ruajtja e solidaritetit në mes të organizatave të grave janë vendimtare për ndërtimin e një lëvizjeje të qëndrueshme të grave, të cilës konkurrenca nuk ia minon përpjekjet drejt qëllimeve të përbashkëta. RrGK ka shënuar progres drejt arritjes së këtij rezultati përmes arritjes së rezultateve të pritshme të shënuara më poshtë.



Anëtares e RrGK-së janë informuar për nismat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGK, mundësitë e financimit dhe informacione të tjera

RrGK ka organizuar pesë takime të rregullta dymujore të anëtareve, përmes të cilave 225 anëtare, partnerë dhe përkrahës të ndryshëm kanë shkëmbyer informata; u organizuan 36 iniciativa të përbashkëta; dhe u informuan për aktivitetet që po zhvilloheshin në vazhdimësi nga RrGK dhe nga organizatat tjera. Gjatë takimeve, anëtares e RrGK-së luajtën rol të rëndësishëm në bashkëpunimin drejt zbatimit të strategjisë së RrGK-së, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e punës së RrGK-së.



Më shumë vajza aktiviste të përfshira në lëvizjen e grave

RrGK ka postuar dhe ka shpërndarë informata në faqen e Facebook-ut të FemACT duke u munduar të përfshijë vajza dhe djem në aktivitetet e ndryshme. RrGK ka ofruar punë praktike për katër vajza, ndërkaq punë vullnetare për 23 vajza. Kjo u ka dhënë mundësi atyre të bëhen të shkathëta në organizim, hulumtim, avokim, integrim të çështjeve gjinore në avokimin për të drejtat e njeriut dhe në marrëdhëniet me publikun, fuqizim të shkathësive të anëtarëve të lëvizjes së grave të Kosovës.



Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimi ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile në Kosovë dhe Serbi

Krahas ndërtimit të bashkëpunimit përmes takimeve të rregullta të RrGK-së dhe nismave të përbashkëta të avokimit, RrGK u ka ofruar mundësi për bashkëpunim ndëretnik organizatave që kanë marrë grante përmes Fondit të Grave të Kosovës dhe përfituesëve të tyre. Gjatë këtij viti organizatat partnere Naš Dom & Qendra e Grave për Zhvillim Rural kanë zhvilluar iniciativën "Përmirësimi i politikave lokale nga perspektiva e grave", përderisa organizatat Dera e Hapur & Ruka Ruci kanë zhvilluar iniciativën: "Fuqizimi i Grave aktiviste nga komuniteti për të çuar përpara të drejtat e grave dhe barazinë gjinore përmes pjesëmarrjes, informative dhe mediave sociale".

Rrjeti i Grave në të Zeza, në Serbi, gjatë muajit shtator ka organizuar takimin regional dy-ditor në Shkup në formatin e punëtorisë për temën e paqes, sigurisë dhe drejtësisë. Gjatë këtyre dy ditëve, ato diskutuan vazhdimësinë e Gjykatës së Grave për drejtësinë alternative për krimet e kryera ndaj grave gjatë viteve 1990.


Është përmirësuar kapaciteti institucional i RrGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtarët e saj që e mbajnë gjallë lëvizjen. Prandaj, RrGK vazhdimisht mbështetë anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre. Punëtoritë, sesionet e mentorimit dhe Fondi i Grave të Kosovës kanë përkrahur anëtarët e RrGK-së në avancimin e organizatave të tyre.



Puna e RrGK dhe e anëtareve të saj mëe promovuar tek partnerët potencial, tek aktivistet e grave nëmbare botën dhe tek përkrahësit potencial

RrGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGK-së, faqen e Facebook-ut, dhe buletin elektronik mujor *Zëri i Grave Kosovare*. RrGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 8,620 që ishin në vitin 2016 në 16,498



Grafi 1. Ndjekësit e faqës së RrGK në Facebook gjatë vitit 2017 sipas moshës dhe gjinisë

në vitin 2017. Faqja në Facebook e RrGK-së lidhur me "FemACT"-in ka 802 ndjekës. RrGK gjithashtu menaxhon faqen e Lobit për Barazi Gjimore që tani ka 1,864 ndjekës. Gjithashtu, RrGK-ja vazhdon të përdorë medime të tjera sociale, siç është Twitter-i, në të cilin numri i ndjekësve është rritur nga 594 në 647 dhe në Instagram, ku numri ndjekësve u rrit nga 669 në 1,101. Këtë vit RrGK-ja ka pasur 12,357 vizita në faqen e internetit; 37,756 sesione; dhe 24,495 përdorues. RrGK ka shkruar rregullisht artikuj për



anëtarët e saj në buletinin mujor *Zëri i Grave Kosovare*, i cili lexohet nga qindra njerëz nëpër botë. RrGK gjatë vitit 2017 ka dërguar 27 reagime/kumtesa për media:

1. RrGK i bashkohet marshit botëror “Gratë Marshojnë” (19 janar);
2. Publikohet nesër raporti i parë gjithëpërfshirës në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor në Kosovë (1 shkurt);
3. Rogova folëse në “NATO talk” në Bruksë (9 mars);
4. RrGK Kërkon Hetim Policor në Skandalin e Fundit të Klinikës Gjinekologjike në QKUK (8 prill);
5. RrGK dënon kërcënimet ndaj Arbana Xharrës (12 prill);
6. Drejtësia kosovare promovon vrasjet: Vetëm 12 vite burgim për vrasësin e Zejnepe Berishës (12 prill);
7. Drejtësi Për Zejnepën (13 prill);
8. Kërkesë për themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare në Kosovë, dërguar Kryeministrit të Kosovës z. Isa Mustafa, nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Rrjeti i Grave të Kosovës, Medica Kosova, Medica Gjakova dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave (13 prill);
9. Medica Gjakova organizon Konferencën "Fuqizo Gratë, Tani" (10 maj);
10. RrGK dënon ashpër dhunën ndaj Arbana Xharrës (13 maj);



11. RrGK bën thirrje për përfaqësim të barabartë gjinor në listat e kandidatëve nga subjektet politike (25 maj);
12. RrGK bën thirrje: Voto për Gratë! (6 qershor);
13. Parlamenti Evropian diskuton për dhunën ndaj grave në Kosovë dhe rajon (7 qershor);
14. Fondi i Grave të Kosovës do të ndajë 99,842.35€ për 31 organizata të udhëhequra nga gratë (9 qershor);
15. RrGK kërkon nga z.Beqa të kërkoj falje për deklaratën ofenduese ndaj znj. Mimoza Kusari – Lila (15 qershor);
16. RrGK fton qytetarët të kërkojmë drejtësi për Zejnepen (2 gusht);
17. RrGK - telegram ngushëllimi për ndarjen nga jeta të z. Bajram Rexhepi (21 gusht);
18. RrGK dënon ashpër dhunën ndaj Vitore Stavilecit (29 gusht);
19. RrGK, e pakënaqur dhe e zhgënjyer me numrin e grave përfaqësuese në qeverinë e re: “Ku janë gratë” (11 shtator);
20. Rogova merr pjesë në Takimin e Dytë Vjetor të Panelit Këshillues të NATO-s mbi Rezolutën 1325 (3 tetor);
21. Lansimi i Publikimit: Buxhetimi për bujqësi dhe zhvillim rural më të mirë (9 tetor);
22. Reagim pas vizitës së Zëvendës Sekretares së Përgjithshme të NATO-s Rose Gottemoeller në Kosovë, për të cilën vizitë aktivistet e të drejtave të grave mësuan përmes mediave. Rogova i bën thirrje NATO-s që të sigurojë që në të ardhmen të gjitha delegacionet e nivelit të lartë të



mbajnë takime zyrtare me aktivistë për të drejtat e grave gjatë orarit të rregullt të punës dhe me shikueshmëri të plotë të medias, duke demonstruar publikisht se zërat e grave janë të rëndësishme në lidhje me të gjitha çështjet politike dhe të sigurisë vetëm "çështjet e grave" (28 tetor);

23. RrGK lanson Dokumentin e Politikave: Progresi i Kosovës në përafrimin e ligjeve të saja me ligjet e BE-së mbi barazinë gjinore (7 nëntor);
24. RrGK lanson raportin Buxhetimi për përmirësimin e barazisë gjinore në programet për diasporë (16 nëntor);
25. Në vend të përkujtimit, Një Mikeshtë e Veçantë (19 nëntor);
26. Edhe një grua vdes nga dhuna në familje (24 nëntor);
27. Gratë e Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë të pakënaqura dhe të zhgënjyera me numrin e grave përfaqësuese në qeverinë e re (27 nëntor).

RrGK është përpjekur që të gjitha publikimet dhe shumë prej informatave të publikuara në internet (shpeshherë edhe me mungesë të fondeve për përkthim) t'i ketë në dispozicion në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.



Anëtarët e RrGK aftësohen për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive, për të udhëhequr organizata dhe për të ndërmarrë iniciativa më efektive avokuese

Gjatë këtij viti, RrGK përmes Fondit të Grave të Kosovës ka ndarë gjithsej 27 grante, për 31 organizata anëtare të saj. Prej tyre, katër Grante në Partneritet për Ndryshim (deri në 8,000€) iu ndanë 8 organizatave që punuan në partneritet dhe 23 Grante Avokimi Individual (nga 3,000€ deri në 4,000€) iu ndanë organizatave individualisht. Grantet "Partneritet për Ndryshim" kanë rritur bashkëpunimin midis organizatave anëtare, duke u mundësuar organizatave të rajoneve të ndryshme të Kosovës të bashkojnë forcat dhe të fuqizojnë nismat e tyre duke avokuar së bashku. Për shembull, Medica Kosova në partneritet me organizatën Djepi i Buzëqeshjes zhvilluan iniciativën "Përkrahja e qasjes së nënave vetushqyese të prekura nga lufta në programet e subvencioneve për agrikulturë" si rezultat i të cilës deri më tani 10 gra aplikuan për përfitimin e subvencioneve nga komuna e Gjakovës prej të cilave një grua përfitoi serë dhe moto kultivatorë, gjashtë gra të tjera përfituan moto kultivatorë si dhe një grua përfitoi koshere bletësh dhe pajisje tjera shtesë.



Përkrahësit kryesor të RrGK-së për këtë vit ishin Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, të cilat së bashku kanë kontribuar në FGK me shumën prej 99,842.35€.



Nga vjeshta e vitit 2012 deri me 31 dhjetor 2017, si rezultat i iniciativave të anëtareve të ndryshme kanë përfituar 19,564 persona, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, personat nga zonat rurale, personat e etnive të ndryshme (turq, goranë, serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë dhe shqiptarë) të rinjë dhe pensionistë.

Në vitin 2017, anëtarët e stafit të RrGK-së kanë ofruar 1,347 seanca mentorimi përmes e-mailit, telefonit dhe takimeve një me një për përfitueset e granteve të FGK-së. Komisioni për Shqyrtimin e Granteve, i përbërë prej 7 anëtarëve, po ashtu ka kontribuar në avancimin e kapaciteteve të anëtareve, duke shqyrtuar secilin aplikacion dhe duke dhënë këshilla praktike. Kjo ka ndihmuar anëtarët e RrGK-së që të dorëzojnë aplikacione më të mira të FGK dhe tek donatorë të tjerë.

Gjithashtu, deri më 31 dhjetor, anëtarët e RrGK-së, të përkrahur nga FGK, kanë arritur këto rezultate:



- Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC) zhvilloi iniciativën "Avokimi për zgjerimin e kurrikulës informative në Qendrat Informuese për shëndetin e gruas dhe trajnimi i stafit në Qendra" duke avokuar tek përfaqësues nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, për të vendosur bashkëpunim të vazhdueshëm në mes të AMC-së dhe Universitetit përmes angazhimit të studentëve në projektet e AMC-së. Gjithashtu përmes avokimit tek Udhëheqësja e Divizionit për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës në Ministrinë e Shëndetësisë, depresioni i pas-lindjes u integrua në kurrikulën edukative në Klasat për Nëna.
- Psikoterapeutet në Veprim zhvilluan iniciativën "Fuqizimi i grave viktime të dhunës seksuale dhe torturës gjatë konfliktit në Kosovë, në regionin e Gjilanit" përmes të cilës u identifikuan 30 të mbijetuara të dhunës seksuale në komunën e Gjilanit. Gjithashtu u realizuan takime avokuese tek zyrtaret e institucioneve lokale në Gjilan si dhe me zyrtarët e Entit për Punësim në komunën e Gjilanit përmes të cilëve u punësuan 11 gra të mbijetuara të dhunës seksuale.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) zhvilloi iniciativën "Barazia gjinore drejt anëtarësimit në BE" duke avokuar tek zyrtarët e Ministrisë për Integritet Evropian si dhe zyrtarët nga komuna e Prizrenit. Përmes këtyre takimeve është ngritur vetëdija mbi aplikimin e politikave të ndjeshme gjinore. QKSGJ gjithashtu hartoi udhëzuesin "Barazia gjinore në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE - Udhëzuesi për avokim" për të cilin Ministria për Integritet Evropian dhe Komuna e Prizrenit shprehën përkushtimin që do ta përdorin këtë udhëzues.
- Instituti Alpha zhvilloi iniciativën "Mbrotjtja e të drejtave të njeriut dhe grave të burgosura në Kosovë përmes socializmit të tyre" duke mbajtur 6 trajnime me 20 gra të burgosura në Institutin Korrektues



të Lipjanit me temat: shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë e zgjedhjes së konflikteve, tejkalimi i frustrimeve, stresi dhe tejkalimi i tij, përpunimi emocional, fobitë si dhe mënyrat e tejkalimit të tyre.

- Shoqata e Juristeve Norma zhvilloi iniciativën "Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së transparencës së institucioneve" ku Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Odës së Noterëve iu dërgua kërkesa për rishikimin e rasteve të mbyllura të pronës dhe trashëgimisë në 4 gjykatat themelore, në Prizren, Ferizaj, Podujevë dhe Graçanicë. Në bazë të këtyre rishikimeve janë analizuar të dhënat, problemet si dhe vështirësitë në të cilat hasin gratë gjatë realizimit të drejtave të tyre pronësore. Në bazë të dhënave të mbledhura nga rishikimi është përpiluar raporti mbi të gjeturat i cili është prezantuar në tryezën e rrumbullakët. Përveç këtyre 300 gra dhe vajza në komunën e t: Prizrenit, Ferizajit, Podujevës dhe Graçanicës u informuan më detajisht me kornizën ligjore lidhur me të drejtat e tyre mbi pronën dhe trashëgiminë.
- OJQ Bliri zhvilloi iniciativën "Bëhu pjesë dhe ndihmo në parandalimin e sëmundjeve shekullore" duke avokuar tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunën e Drenasit si dhe duke siguruar shërbime gjinekologjike dhe mamografi pa pagesë për 28 gra dhe vajza. Përveç këtyre u organizuan 20 takime informuese gjatë të cilave u informuan 263 gra dhe vajza nga komuna e Drenasit për të drejtat e tyre shëndetësore si dhe rëndësinë e kujdesit shëndetësor.
- OJQ Rona zhvilloi iniciativën "Avokim për fuqizimin e grave femere në fshatrat e Malishevës" përmes të cilës 125 gra të komunës së Malishevës u vetëdijesuan në lidhje me të drejtat e tyre si dhe mundësitë për përfitimin dhe përkrahje financiare për zhvillimin e ekonomive familjare përmes bujqësisë. Si



rezultat i kësaj iniciative 11 gra kanë marr guximin për të hapur biznese të vogla familjare me kultivimin e bimëve mjekuese si dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve.

- Shoqata Iniciativa e Grave zhvilloi iniciativën "Koha për frymë të re politike" duke mbajtur takime informuese në 5 fshatra të komunës së Dragashit në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse komunale në të cilat morrën pjesë 150 gra dhe vajza të kësaj komune. Si rezultat i kësaj iniciative 36 gra dhe vajza nga kjo komunë u anëtarësuan dhe u angazhuan në parti të ndryshme politike.
- Handikos Mitrovica zhvilloi iniciativën "Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara përmes rritjes së vetëdijesimit rreth të drejtave të tyre pronësore". Gjatë kësaj iniciative u organizuan 8 takime informuese në të cilat morrën pjesë 100 anëtarë, persona me aftësi të kufizuara, nga Mitrovica, Vushtrria dhe Skenderaj. Në këp takime ata u informuan për të drejtat e tyre në trashëgimi dhe pronë. Gjithashtu, u shqyrtuan dhe analizuan 10 raste individuale në sesionet individuale mes juristit dhe anëtarëve me aftësi të kufizuara, gjatë të cilave sesione u përgatiten dokumentet e nevojshme për proceset e mëtutjeshme për realizimin e të drejtës për trashëgimi dhe pronë.
- Shoqata e Grave "Krusha e Vogël" zhvilloi iniciativën "Avancimi i grave dhe vajzave në viset rurale" duke avokuar tek Drejtoria e Arsimit, Qendra për Aftësim Profesional, Drejtoria e Ekonomisë dhe Turizmit Rural, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale. Gjatë kësaj iniciative gjithashtu janë mbajtur trajnime për procedurat e aplikimit për subvencione dhe përkrahje teknike për procedura të tjera komunale dhe shtetërore. Si rezultat i kësaj iniciative 4 prej përfituesve të trajnimeve janë punësuar në pikën grumbulluese të qumështit të kësaj



shoqate. Përveç tyre 8 gra u regjistruan në Entin për Punësim, prej të cilave 2 u punësuan nëflokatori dhe kontabilitet. Gjithashtu, 2 gra aplikuan për subvencione (sera) dhe 2 gra të tjera për mjete bujqësore në Drejtorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- OJQ Foleja zhvilloi iniciativën "Ngritja e nivelit të edukimit shëndetësor për rëndësinë e planifikimit familjar dhe shëndetit riproduktiv" ku përmes avokimit tek Drejtori i Spitalit Rajonal të Prizrenit u sigurua lirimi nga pagesat për shërbimet gjinekologjike me ultrazë dhe pap-test për 30 gra të komunitetit: romë, ashkali dhe egjiptas. Gjithashtu, u realizuan 16 trajnime për 167 gra dhe vajza të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas të fshatrave të komunës së Prizrenit mbi shëndetin riprodhues dhe rëndësinë e tij.
- Medica Kosova në partneritet me organizatën Djepi i Buzëqeshjes zhvilluan iniciativën "Përkrahja e qasjes së nënave vetushqyese të prekura nga lufta në programet e subvencioneve për agrikulturë" përmes të cilit janë mbajtur 20 trajnime për 40 gra, nëna vetushqyese nga komuna e Gjakovës mbi mundësitë dhe të drejtat e tyre për përfitim nga subvencionet shtetërore. Përveç këtyre u mbajtën dhe takime avokuese me institucione lokale për përfitimin e grave nga programet e subvencioneve për agrikulturë. Si rezultat i kësaj iniciative 10 gra aplikuan për subvencioneve nga komuna e Gjakovës prej të cilave një grua përfitoi serë dhe moto-kultivatorë. Përveç kësaj edhe gjashtë gra tjera përfituan moto-kultivatorë si dhe një grua përfitoi koshere bletësh dhe pajisje tjera shtesë.
- Qendra Për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve "Liria" në partneritet me Legjendën zhvilluan iniciativën "Ngritja e pozitës së gruas në proceset e paqe-bërjes dhe buxheti gjinor". Gjatë



kësaj iniciative janë mbajtur trajnimet me 41 zyrtarë nga komuna e Ferizajt dhe Kllokotit. Përveç trajnimeve, zyrtarët përfituan njohuri edhe përmes shkëmbimit të përvojave të cilat janë bërë me zyrtarë nga komuna e Kamenicës. Si rezultat i kësaj iniciative komuna e Ferizajt bëri hartimin e politikave gjinore. Kjo komunë tani është në fazën e planifikimit të kornizës afatmesme si dhe analizave gjinore në sferën e papunësisë.

- Qendra për Art dhe Komunitet “Artpolis” në partneritet me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave zhvilloi iniciativën "Njohja dhe promovimi i të drejtave të shëndetit riprodhues dhe edukimi seksual përmes artit dhe angazhimit të të rinjëve" gjatë të cilës janë mbajtur sesionet vetëdijesuese si dhe aktivitete të ndryshme. Përmes artit 130 gra dhe vajza nga komuna e Prishtinës dhe Drenasit u vetëdijesuan në lidhje me të drejtat e shëndetit riprodhues dhe edukimin seksual. Organizatat partnere avokuan tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologisë për futjen e edukimit seksual në kurrikulat mësimore për shkollat e mesme.
- Gruaja Bashkëkohore zhvilloi iniciativën “Shëndeti dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese” duke avokuar tek tetë zyrtarë, përfaqësues të institucioneve shëndetësore lokale dhe qendrore përmes letrave publike për zbatim më të mirë të Ligjit për Shëndetin Riprodhues në Kosovë. Ato informuan 75 vajza, nxënës të shkollave të mesme, fillore dhe universiteteve të ndryshme në lidhje me shëndetin riprodhues të grave, seksualitetin, sëmundjet seksuale të transmetueshme, abortin dhe shtatzëninë e hershme.



- Shoqata e Grave "ATO" zhvilloi iniciativën “E drejta ime në pronë” duke informuar 85 gra dhe vajza të Komunës së Vushtrrisë mbi të drejtat e tyre mbi trashëgiminë. Poashtu, katër gra filluan procedurën për regjistrimin e pronës në emrin e tyre apo në bashkëpronësi me bashkëshortet e tyre.
- Shoqata e Grave "Krusha e Vogël" avokoi tek Drejtoria e Bujqësisë, që grantet të shpërndahen në mënyrë të barabartë tek gratë dhe burrat. Kjo shoqatë trajnoi 20 gra dhe pesë burra për mënyrën e aplikimit për subvencione dhe përkrahje nga Komuna e Prizrenit, ku 10 nga këto gra përgatitën aplikacionet e tyre për të aplikuar tek Drejtoria e Bujqësisë në thirrjen e radhës. Përveç këtyre, me përkrahjen e kësaj shoqate gjashtë gra hapën biznese të vogla familjare.
- Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave në partneritet me Qendrën për Promovimin e Familjes së Shëndoshë zhvilluan iniciativën “Fuqizimi i të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës për realizimin e të drejtave ligjore” duke informuar 120 gra dhe burra në lidhje me të drejtat specifike që garantohen me ligj (të drejtat për pension, të drejtat për strehim e rehabilitim si dhe të drejtat për arsimim). Njëherit, 120 gra kanë marrë mbështetje teknike për të plotësuar dokumentacionin për përfitimin e statusit të viktimave civile. Krahas kësaj, janë dokumentuar 50 histori personale të krimeve gjatë luftës në Kosovë.
- Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar zhvilloi iniciativën “Vetëdijësimi për përkrahje dhe mbështetje të personave të verbër dhe personave me të pamurit të dobësuar” duke avokuar me sukses tek Drejtoria e Arsimit, ku katër fëmijë të verbër u regjistruan në Shkollën Speciale për të Verbër në Pejë, dhe një fëmijë me të pamurit e dobësuar në shkollimine rregullt fillor, si dhe u siguran



klasat për zhvillimin e kurseve për mësim të shkrim-leximit sipas alfabetit të brajllit. Poashtu, është avokuar me sukses edhe tek Drejtoria e Urbanizimit, ku komunikacioni rrugor për të verbërit është futur në planin urbanistik për vitin vijues. Më tej, 46 persona të verbër janë informuar rreth të drejtave të tyre në shëndetësi, çështje sociale dhe juridike. Poashtu, 50 familjar të këtyre personave u informuan për trajtim të mirëfilltë të të verbërve dhe trajtim të barabartë me anëtarët e tjerë të familjes.

- Partners Kosova zhvilloi iniciativën "Avokimi i grave për të drejtat e tyre pronësore dhe ato të trashëgimisë" duke informuar 85 gra dhe burra në lidhje me të drejtat e tyre pronësore si dhe rrugët ligjore që duhet ndjekur në rastet e kërkimit të ndarjes së pronës dhe trashëgimisë. Janë bërë tetë monitorime në zyrat e Ofiqarisë dhe të Kadastrit për të parë se sa prona po regjistrohen në emër të grave dhe sa po respektohet afati ligjor për regjistrimin e pronës.
- Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës (KGVK) zhvilloi iniciativën "Më shumë të drejta për gratë e verbëra" duke informuar 20 gra dhe burra në lidhje me të drejtat e tyre në arsim të cilat i kanë të garantuara me ligjin 04/L-092.
- Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut zhvilloi iniciativën "Gratë vendimmarrëse" duke informuar dhe trajnuar 14 kandidate të reja për asamble komunale për aftësitë udhëheqëse gjatë fushatës zgjedhore në muajin tetor. Më tej, katër kandidate të reja nga lista zgjedhore në vitin 2017, pjesëmarrëse të këtyre trajnimeve u bënë anëtare të kuvendit komunal në Mitrovicën Jugore.
- Qendra e Kosovës për Zhvillim dhe Integrim Multikulturor zhvilloi iniciativën "Fuqizimi ekonomik i të rinjve nga komunitetet jo-shumicë rom, ashkali, egjiptian, me fokus tek vajzat" me ç'rast janë



identifikuar 29 të rinj romë dhe egjiptian të cilët kishin diplomuar në universitet, por ishin të papunë. Këtyre të rinjëve i'u është ofruar mundësia për të ndjekur kurse të ndryshme si: kurse kompjuterike, kurse të gjuhës angleze dhe kurse për aftësim në të folur.

- Girls Coding Kosova zhvilloi iniciativën "#EcShlirë v.3.0. – Bashkëpunimi me policinë e Kosovës" duke trajnuar gjashtë policë të Kosovës, gjashtë zyrtarë nga Komuna e Prishtinës dhe një zyrtar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Kosovës për përdorimin e aplikacionit dhe të dhënat e ngacmimeve që do të raportohen përmes tij. Është lidhur marrëveshja me Policinë e Kosovës për të përdorur raportet e dalura nga ky aplikacion për të hetuar ngacmimet seksuale dhe për të përmirësuar sigurinë. Më tej, 26,500 persona u ndërgjegjësuam rreth ngacmimit seksual nëpërmjet lancimit të një video në media.
- Instituti i Psikologjisë Aplikative “Alpha” zhvilloi iniciativën “Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe grave të burgosura në Kosovë përmes socializmit të tyre (II)” duke u ofruar trajnime 15 grave të burgosura në Institucionin Korrektues të Lipjanit. Temat e trajnimit ishin: ndjenjat e fajit, teknikat dhe mënyrat e eliminimit të shqetësimeve, rritja e vetëbesimit, falja dhe pranimi etj. Njëherit, është punuar me 15 punonjës të Institucionit Korrektues në Lipjan dhe kanë avokuar për ofrimin e më shumë mundësive për punë dhe aktiviteteve rekreative për të burgosurat.
- Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes zhvilloi iniciativën “Një grua e edukuar, një shoqëri e shëndoshë”, gjithësej janë mbajtur 12 punëtori me 230 gra dhe vajza nga Komuna e Gjakovës si dhe u zhvilluan pyetësor me këto gra dhe vajza lidhur me ndërgjegjësimin e tyre për



të drejtat dhe rëndësinë e kujdesit shëndetësor. Nga 230 gra, 22 prej tyre kryen vizita gjinekologjike pa pagesë. Më tej, u avokua tek Drejtoria e Shëndetësisë në Gjakovë për hapjen e zyrës për konsultime gjinekologjike për vajzat e reja. Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës zhvilloi iniciativën “Kujdesi shëndetësor është i mirë atëherë kur ka qasje për të gjithë” duke mbajtur takime të rregullta mujore me 20 gra dhe vajza, ku u diskutuan tema të ndryshme mbi shqetësimet dhe pengesat që ato kishin. Njëherit, u organizuan katër takime, ku specialistët e shëndetësisë mbajtën ligjerata. U përpiluan dhe pyetësorë të cilët shërbenin për mbledhjen e informatave më specifike mbi nevojat e shëndetit parësor të personave me distrofi muskulare dhe nevojat e familjarëve të tyre. Këto informacione shërbyen për të nxjerrë një raport dhe rekomandime më specifike, që më pastaj i janë dorëzuar institucioneve. U avokua tek përfaqësuesit e drejtorive shëndetësore, barazisë gjinore dhe institucioneve të nivelit lokal për përmirësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore.

- Vita Jeta zhvilloi iniciativën “Diabeti tek të moshuarit” duke u informuar 284 gra dhe 43 burra mbi temat e ndryshme si: diabeti, ushqimi, terapia, higjiena e personave me diabet, vet-kontrollimi. Pas secilit leksion, të gjithë pjesëmarrësve u është bërë matja e glukozës me qëllim të njohjes, ndërgjegjësimit dhe monitorimit të kësaj sëmundjeje. U avokua tek Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunë e Prishtinës, për t’i mundësuar grave dhe burrave kujdes shëndetësor sa më cilësor e në veçanti shërbimet për diabet.



- Qendra për Fuqizimin e Gruas zhvilloi iniciativën “Fuqizimi ekonomik i grave - nënave kryefamiljare” me ç’rast avokuan tek kryetarët dhe zyrtarët e këshillit gjyqësor, gjykatave etj, duke kërkuar shqyrtimin e rasteve për alimentacion dhe pronësi, njëherit duke adresuar të gjitha shqetësimet dhe padrejtësitë që u janë bërë grave dhe fëmijëve të tyre. U botua një libër-tregues i grave kryefamiljare, që kërkuan këto të drejta. Ky libër është shkruar pas 24 intervistave me këto gra. Nëpërmjet këtyre tregimeve, të cilat janë të shënuara me initiale për të ruajtur identitetin, krijohet një pamje e qartë se si trajtohen çështjet gjyqësore dhe problemet që hasin gjatë këtij rrugëtimi.
- Luna zhvilloi iniciativën “Shëndeti i grave dhe liria e lëvizjes” përmes së cilës 68 gra dhe vajza u njoftuan rreth kancerit të gjirit dhe të qafës së mitrës, për rëndësinë e vet-ekzaminimit dhe mbështetjes së grave të prekura nga këto sëmundje. U ofruan konsultime individuale lidhur me problemet e tyre shëndetësore.
- Më tej, u avokua për ofrimin e shërbimeve gjinekologjike në qendrat e mjekësisë familjare të fshtarave si: Prilluzhe, Plemetin dhe Gojëbulë. Njëherit, avokuan tek Komuna e Vushtrrisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim për sigurimin e linjës së transportit që do të kalojë nëpër këto fshatra.
- Together in Progress zhvilloi iniciativën “Nga Nënrat - Avokim për gratë femere të komunës së Gjakovës”. Në kuadër të kësaj iniciative u organizuan tre fokus grupe me temat: 1) Fuqizimi i ekonomisë blegtorale/bujqësore, 2) Fuqizimi dhe asistimi i grave me ekonomi blegtorale nga



institucionet publike dhe 3) Mundësia e subvencionimit për këto biznese, ku morrën pjesë gratë përfituese të projektit, përfaqësues nga shoqëria civile, zyrtarë ku bashkëpunuan për të dhënë rekomandime se si t'u sigurojnë grave fermere hapësirën për shtijen e prodhimeve të tyre. U realizua kërkesa e grave fermere për shfrytëzimin e hapësirës 'Namasgjah' pa pagesë ose me një shumë të vogël simbolike.

- Iniciativa për Integrim të Komuniteteve zhvilloi iniciativën "Përmirësimi i pozitës së vajzave dhe grave përmes përfshirjes së tyre në vendimmarrje në Komunën e Dragashit" duke informuar 33 gra lidhur me të drejtat e trashëgimisë, pronës dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në proceset politike dhe vendimmarrje. Krahas kësaj, u punësuan katër gra që kishin aplikuar si këshilltare komunale në Komunën e Dragashit.
- Lulishtja zhvilloi iniciativën "Promovimi i të drejtave të grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në trashëgiminë pronësore" duke informuar 215 gra dhe pesë burra nga 20 fshatrat e komunës së Prishtinës dhe Podujevës në lidhje me të drejtat e tyre mbi pronën dhe trashëgiminë. Po ashtu, u ofrua asistencë ligjore për gratë që kishin nevojë për informata më të detajuara.
- OJQ Bleri zhvilloi iniciativën "Ngritja e vetëdijes së shëndetit riproduktiv tek të rinjtë" duke informuar 400 nxënës të shkollave të mesme mbi temat si: kujdesi shëndetësor, preventivat e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, si dhe përsëmundjet apo dukuritë e shekullit si SIDA, droga dhe duhanpirja. Janë mbajtur sesione informuese me 400 gra për sëmundje të tilla si: kanceri i gjirit dhe qafës së mitrës. Është avokuar me sukses tek institucionet shëndetësore duke i'u



mundësuar vizita dhe shërbime gjinekologjike falas. Përmes kësaj iniciative 15 gra kanë kryer shërbime gjinekologjike pa pagesë.

- Gruaja Hyjnore zhvilloi iniciativën” Ngritja e vetëdijes së qytetarëve mbi të drejtën e grave në pronë dhe trashëgimi” duke organizuar tetë punëtori të ndryshme që përfshijnë gratë dhe vajzat e moshës 25-55 vjeçare. Punëtoritë kishin për qëllim rritjen e njohurive të pjesëmarrësve për ligjet vendore që garantojnë barazinë gjinore, me fokus të veçantë rëndësinë e trashëgimisë dhe të drejtën në pronë, duke përfshirë legjislacionin e pronës dhe trashëgimisë. Përveç kësaj, kishte edhe grupe punuese në fshatrat Breslac, Velekinkë dhe Malishevë. Për të siguruar që rekomandimet e dala nga këto punëtori do të zbatohen, në kuadër të këtij projekti janë organizuar edhe takime avokuese me përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit, Zyrës për Barazi Gjinore dhe Drejtorisë për Regjistrim dhe Kadastër nga e njëjta komunë.
- Klubi Social Jeto zhvilloi iniciativën “Qasje më e lehtë e grave në drejtësi për mosmarrëveshje apo konteste pronësore” duke organizuar kështu 13 prezantime në komunitete dhe shkolla të ndryshme nga rajonet e Deçanit, Junikut, Gjakovës dhe Prishtinës. U zhvilluan disa fushata ndërgjegjësuese, tryeza të rumbullakëta, trajnime dhe seminare ku për qëllim kishin promovimin e të drejtave të njeriut, rritjen e pjesëmarrjes në jetën shoqërore dhe ekonomike për të gjitha grupmoshat. Gjithësej, 129 pjesëmarrës përfituan nga ky projekt, 113 gra dhe 16 burra. Njëherit u avokua tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe tek Qendrat për Punë Sociale në komunat e Junikut, Deçanit dhe Gjakovës. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve u informuan për rëndësinë e ndërmjetësimit në mënyrë që gratë dhe vajzat të kenë mundësi të shprehin vullnetin



e tyre, të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre, të jenë në gjendje të jenë të barabarta me palën tjetër si pjesë e procedurës dhe të jenë të informuara për punën e zyreve të ndërmjetësimit në shtatë rajonet e Kosovës.

- Handikos Mitrovica zhvilloi iniciativën “Qasja e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në kujdesin shëndetësor” duke organizuar 8 takime informuese, me 98 anëtarë të kësaj organizate në lidhje me të drejtat e tyre për kujdesin shëndetësor. Gjithashtu u organizuan 10 sesione individuale midis përfituesve dhe mjekut, ku morën udhëzime mjekësore sipas disa çështjeve shëndetësore. Po ashtu, janë organizuar takime avokuese me përfituesit e projektit dhe institucionet shëndetësore lokale, ku avokuan për ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Education Code zhvilloi iniciativën “Gratë sipërmarrëse” me ç’rast 36 gra udhëheqëse të bizneseve të vogla mbajtën trajnime mbi temat: krijimi dhe zhvillimi i mikrobizneseve, problematikat e grave në biznes dhe tejkalimi i tyre, dhe ndikimi i çështjes pronësore në veprimtaritë biznesore të grave. Krahës kësaj, u organizuan vizita dhe sesione këshilluese për të mbështetur përfituesit me bizneset e tyre. U avokua me sukses tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, duke nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për të rritur numrin e trajnimeve, mentorimeve dhe përkrahjen e bizneseve të këtyre grave. Po ashtu, u nënshkrua dhe një Memorandum Mirëkuptimi me MBPZHR-në, për të organizuar sesione informuese dhe këshilluese në komunitet e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës, para skemave të granteve dhe subvencioneve, në mënyrë që gratë sipërmarrëse nga



komunat të kenë mundësi të informohen në lidhje me mënyrat e zhvillimit të mëtutjeshëm të bizneseve bujqësore dhe artizanale.

- Rikotta & Shoqata e “Grave Gora” zhvilluan iniciativën “Vetëdijesohu, shëndeti juaj është i rëndësishëm për shoqërinë” duke informuar 120 goranë, torbesh dhe gra serbe nga komuna e Prevallës mbi temat: infeksionet seksuale të transmetueshme, metodat bashkëkohore të planifikimit familjarë, HIV/AIDS, përdormi i mjeteve kontraceptive, shërbimet shëndetësore të ofruara në Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF), në këtë rast në Prizren, si dhe sëmundjet malinje – kanceri i gjirit dhe i qafës së mitrës. U avokua me sukses tek Komuna e Prevallës, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Shëndetësisë në Prizren dhe tek Instituti i Shëndetit Publik, ku i’u mundësua grave të kenë vizita gjinekologjike dhe kontrolla të ndryshme falas në QMF në Reçan.
- *Naš Dom & Qendra e Grave për Zhvillim Rural* zhvilloi iniciativën “Përmirësimi i politikave lokale nga perspektiva e grave” me ç’rast 31 gra shqiptare dhe serbe u trajnuan mbi temat si: ngritja e vetëdijes së grave mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse, si dhe krijimi i marrëdhënieve dhe komunikimit më të mirë në mes të bartësve të së drejtave dhe ushtruesve. Më tej, u formua trupi joformal ndërkomunal i cili krijoi dokumentin punues me prioritetet e grave nga këto tri komuna: Gjlani, Novobërda dhe Kamenica. Përmes këtij dokumenti, grupi joformal avokoi tek institucionet lokale për miratimin e rekomandimeve nga ky dokument.



- *Dera e Hapur & Ruka Ruci* zhvilloi iniciativën “Fuqizimi i Grave aktiviste nga komuniteti për të çuar përpara të drejtat e grave dhe barazinë gjinore përmes pjesëmarrjes, informatave dhe mediave sociale” duke trajnuar 22 gra shqiptare dhe serbe mbi temat si: përdorimi i internetit, ndarja e tregimeve, nxjerrja në pah e çështjeve me interes për gratë, propozimi i zgjidhjeve, gratë dhe siguria sociale, vetëkujdesi dhe privatësia e nevojshme, aktivizmi në internet dhe përdorimi i mediave sociale. Më tej, 400 gra morën pjesë në dy punëtori, ku u informuan se si gratë mund të jenë më aktive në proceset vendimmarrëse duke ngritur zërin përmes iniciativave të ndryshme vetëdijesuese.

Shtojca I përmban një listë të të gjitha granteve të ndara nga FGK-ja në vitin 2017 dhe të arritjeve të tyre.

Kapacitetet e stafit të RrGK janë rritur

RrGK, gjatë vitit 2017, ka vazhduar të ofrojë mundësi për anëtarët e stafit të saj, që të rrisin kapacitetet e tyre:

- 1) Në prill, Gentiana Murati, Koordinatore e Fondit të Grave të Kosovës, mori pjesë në vizitën studimore në Bosnje dhe Hercegovinë (BeH). Fondacioni Kvinna till Kvinna (KtK), njëherit edhe organizatore e kësaj vizite studimore, mboldhi në Bosnje dhe Hecegovinë tetë organizata nga Kosova dhe tetë organizata nga Bosnja për të ndarë përvojat, mësimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen organizatat që punojnë për të drejtat e grave.



- 2) Iliriana Banjska, Analiste për Çështje Gjinore, në muajin prill mori pjesë në disa takime avokuese në Bruksel, të organizuara nga KtK, gjë që rezultoi në përmirësimin e shkathtësive për avokim në nivel evropian.
- 3) Në maj të këtij viti, KtK organizoi një vizitë studimore në Stokholm të Suedisë, ku mori pjesë Adelina Berisha, Koordinatorë për Avokim dhe Hulumtuese. Ajo pati mundësinë që për së afërmi të njohet me punën që shteti i Suedisë bën në luftim të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Poashtu, kjo ishte një mënyrë e mirë për t'u rrjetëzuar me organizatat tjera të rajonit dhe të shkëmbehen inormata.
- 4) Në shtator, poashtu nën organizmin e KtK, Adelina Berisha vizitoi Vjenën e Austrisë. Kjo vizitë studimore kishte për qëllim të ngriten kapacitetet avokuese të pjesëmarrëseve në luftim të dhunës ndaj grave dhe vajzave.
- 5) Miranda Avdullahu, Asistente në Projektet për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor ishte pjesëmarrëse në punëtoritë Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Prishtinën, të organizuar nga Komuna e Prishtinës si dhe në punëtorinë për Integrimin e Perspektivës Gjinore në Kulturë dhe Art në Kuadër të FemArt.
- 6) Mirjeta Dibrani, Asistente e Granteve në FGK, mori pjesë në punëtorinë "Barazia gjinore", e organizuar nga Instituti Kosovar i Administratës Publike. Ajo gjithashtu mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga KtK në Tiranë, për organizatat partnere lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin e Projekteve.
- 7) Gresa Rrahmani, Këshilltare ligjore, mori pjesë si organizatore në Karvanin e Dialogut të mbështetur financiarisht nga OSBE në Kosovë. Ky karvan udhëtoi nëpër komuna të ndryshme të Kosovës dhe Serbisë



duke nxitur diskutime rreth të drejtave të grave dhe organizoi punëtori për të përmirësuar situatën e tyre. Karavani i jetësuar nga gratë e reja nga të dy vendet shërbeu gjithashtu si një urë bashkëpunimi, dialogu dhe paqe-ndërtimi.

- 8) Në muajin prill, Nertila Qarri Gërguri, Koordinatore e Projektit morri pjesë në “Trajnimin mbi Perspektivën Gjinore Në Bashkimin Evropian”, organizuar nga Austrian Development Cooperation (ADC) për stafin e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe të gjithë partnerët e ADA në Kosovë. Më tutje, gjatë muajit maj, ajo morri pjesë edhe në punëtorinë mbi “Standardet sociale” të organizuar nga ADC/ADA. Ndërkaq, në muajin korrik, ajo morri pjesë në punëtorinë “Integrimi i Qasjes së Bazuar në të Drejtat e Njeriut (QBDNJ) në Arsimin e Lartë” të organizuar nga Projekti HERAS.
- 9) Alba Loxha, Koordinatore për Marrëdhënie me Publikun ishte pjesëmarrëse e punëtorisë për trendet dhe zhvillimet e fundit në media dhe rrjete sociale organizuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna në muajin maj në Prishtinë.
- 10) Bazuar në përgjegjësitë e tyre, anëtarët e stafit të RrGK-së kanë pranuar trajnim-gjatë-punës lidhur me: buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, analizën e buxhetit, aftësitë intervistuese, shkrimin e koncept dokumenteve, hartimin e strategjive avokuese, shkrimin e raporteve, monitorimin dhe vlerësimin, metodat e hulumtimit, përzgjedhjen e mostrës, aftësitë e të folurit publik, dhe ndarjen e dokumenteve në internet.
- 11) Disa anëtare të RrGK-së janë mentoruar gjatë punës.



Është përmirësuar klima e financimit për organizatat për të drejtat e grave

Edhe pse disa iniciativa avokuese mund të merren edhe në baza vullnetare, Organizatat e Shoqërisë Civile (OshC) të udhëhequra nga gratë ende kanë nevojë për burime të ndryshme në shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme.

Me 22 nëntor, organizuar nga Parlamenti Evropian (PE), në bashkëpunim me Fondacionin Kvinna till Kvinna, RrGK ishte pjesëmarrëse në tri panelet të cilat përqëndruan diskutimin në: I) integrimi i çështjeve gjinore dhe të drejtave të grave në procesin e anëtarësimit në BE: shembuj nga raportet e progresit për vendet; II) reformat sociale, duke përfshirë edhe pushimin e lehonisë: kush përfiton?; dhe financimi i BE-së për organizatat e grave; dhe III) cilat janë sfidat dhe mundësitë?. RrGK, ndër të tjera theksoi rolin e rëndësishëm që kanë organizatat e të drejtave të grave në bërjen e ndryshimeve të qëndrueshme brenda komuniteteve të tyre si dhe rëndësinë për nevojat e organizatave të të drejtave të grave për fonde dhe lloje të ndryshme modalitetesh financimi për të komunikuar/mbërritur te organizata të ndryshme.

Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon burime financiare dhe RrGK do të vazhdojë përpjekjet e saj në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendor dhe ndërkombëtar për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe më gjerë.



Përmirësimi i vetëdijesimit institucional dhe publik për rëndësinë e zbritjeve tatimore për të mbështetur punën e rëndësishme të grupeve të të drejtave të grave

RrGK do të angazhohet në këtë çështje në vitet e ardhshme.

Është zbatuar plani i RrGK-së për ngritjen e fondeve

RrGK ka vazhduar ngritjen e fondeve gjatë vitit 2017 dhe ka arritur që të sigurojë shumicën e burimeve financiare të nevojshme për të bërë të mundur progresin në zbatimin e strategjisë edhe për vitin e ardhshëm.

GRATË NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror. RrGK ka shënuar përparim drejt pëmbushjes së këtij qëllimi, siç e ilustronj edhe të arriturat dhe rezultatet në vazhdim.

Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore

Nëse gratë do të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror, numri i grave që marrin pjesë dhe cilësia e pjesëmarrjes së tyre duhet të rritet. Drejt arritjes së këtij qëllimi,



599 gra të ndryshme kanë marrë pjesë në politikë dhe procese vendimarrëse përmes iniciativave të FGK-së gjatë vitit 2017. Në të njëjtën kohë, cilësia e pjesëmarrjes është përmirësuar gjë që është vërtetuar nga çështjet të dilat janë diskutuar mes grave dhe zyrtarëve përmes këtij veprimi. RrGK ka kontribuar në këtë arritje përmes rezultateve të shënuara më poshtë gjatë vitit 2017.

Grupet Avokuese për Barazi Gjinore (GABGJ) të themeluara dhe funksionale në 27 komuna dhe në nivel kombëtar

Në vitin 2014, anëtarët e GABGJ-së kanë themeluar Lobin Kosovar për Barazi Gjinore (LKBGJ). Anëtarët vendosën që edhe burrat dhe djemtë që përkrahin të drejtat e barabarta për gra dhe burra, mund t'i bashkangjiten këtij grupi. Aktualisht, grupet e Lobit ekzistojnë në 27 komuna.

Me 4 mars 2017, Rrjeti i Grave të Kosovës në bashkëpunim me gratë nga Mitrovica, njëkohësisht nikoqiret e kësaj mbledhje, organizuan mbledhjen e Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë. Tema e kësaj mbledhje ishte “Strategjitë avokuese për vitin 2017”. Në këtë takim morrën pjesë 69 gra dhe vajza, duke përfshirë zyrtarët për barazi gjinore, asambleistët dhe përfaqësueset e organizatave anëtare të RrGK-së nga komuna të ndryshme të Kosovës dhe anëtarët e stafit të RrGK-së.

Me 20 maj, në Mamushë, 66 anëtare të Lobit, përfaqësues të institucioneve lokale, organizatave ndërkombëtare dhe anëtare të stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës morrën pjesë në mbledhjen e radhës të Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë. Në këtë mbledhje iu dha hapësirë për prezantime edhe organizatës ndërkombëtare National Democratic Institute (NDI), gjegjësisht aktivitetëve të Akademisë së Grave për LiderShip që është vazhdimësi e aktivitetit “Java e Gruas”. Gratë pjesëmarrëse të Akademisë



të ndara në katër grupe tematike: 1. Ekonomi, 2. Shëndetësi, 3. Arsimit dhe 4. Roli i grave në pozita vendimmarrëse, morrën edhe dhjetëra rekomandime nga anëtarët e Lobit, për tu përfshirë më pas në platformën e propozimeve konkrete për leadershipin e partive politike.

Me 8 shtator, në Deçan, u mbajt mbledhja e radhës e Lobit ku morrën pjesë 104 anëtarë të Lobit, përfaqësues të institucioneve lokale, organizatave ndërkombëtare dhe anëtarë të stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës, ku mysafire nderi ishin edhe znj. Atifete Jahjaga, ish-Presidente e Republikës së Kosovës dhe znj. Alexandra Papadopoulou, Shefe e Misionit të EULEX-it në Kosovë. Gjatë kësaj mbledhje, anëtarët e Lobit prezantuan iniciativat avokuese që i kanë ndërmarrë në komunat e tyre deri në majin shtator, si dhe iniciativat avokuese që planifikojnë t'i ndërmarrin deri në fund të vitit.



Gjatë periudhës 24-26 nëntor, në Durrës, u mbajt mbledhja tre ditore e Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë ku morrën pjesë mbi 100 anëtare të Lobit, përfaqësuese të institucioneve lokale dhe anëtare të stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës. Qëllimi kryesor i kësaj mbledhje ishte rrjetëzimi, solidarizimi dhe shkëmbimi i përvojave të përfaqësueseve të komunave me njëra tjetrën, duke bërë kështu të lindin edhe bashkëpunime mes tyre për të përmirësuar pozitën e grave dhe të vajzave në komunat përkatëse. Përveç prezantimit të iniciativave avokuese të ndërmarra deri në këtë periudhë, anëtaaret e Lobit prezantuan edhe nga tre pika kryesore për të cilat do të angazhohen të punojnë gjatë vitit 2018.



Disa nga iniciativat e planifikuara avokuese janë: Të avokohet për vajzat e reja për angazhim në politikë dhe fuqizimi i tyre në subjektet politike; Të avokohet për ndarje të barabartë në pozitat menaxheriale; Të avokohet për punësim dhe strehim për nënat vetushqyese; Të avokohet për fuqizimin ekonomik të grave përmes subvencioneve nëpër komuna; Të avokohet për zgjidhje të problemeve në qasje më cilësore në shërbimet shëndetësore për gratë; Të avokohet për bursa ose çështje tjera me rëndësi për arsimimin e vajzave dhe grave; e të tjera.

Edhe në këtë mbledhje të Lobit ishin të pranishëm përfaqësues të NDI, me qëllimi që të dëgjohojnë zërin e grave për çështjet që ato mendojnë janë të rëndësishme të prezantohen gjatë Javës së Gruas në vitin 2018.

Ngritja e kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e mëtejshme të grave

Takimet e lartpërmendura të Lobit po ashtu zhvilluan edhe më tej kapacitetet e grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira dhe duke i përmirësuar aftësitë e tyre avokuese.

Gjatë këtij vitit, Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballe Rogova, mbajti 284 seanca mentorimi me grupet e Lobit nëpër Kosovë. Këto seanca shërbyen për të fuqizuar anëtarët e Lobit në avokimin e tyre për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përmes vizitave në komunat e tyre apo përmes thirrjeve telefonike. Është e rëndësishme të theksohet që RrGK-ja nuk i sheh apo trajton anëtarët e Lobit si anëtare të partive politike, por më tepër si udhëheqëse në komunat e tyre. Drejtorja ekzekutive e RrGK-



së, gjithashtu ishte e pranishme në ngjarjet e tyre, ka promovuar iniciativat e tyre, i ka mbështetur ato në iniciativat e tyre të avokimit duke iu bashkuar atyre në takimet me zyrtarët lokalë në çështje të ndryshme dhe i ka asistuar në tejkalimin e problemeve që kanë ndodhur gjatë avokimeve të tyre të planifikuara drejt barazisë gjinore.

Iniciativat e marra nga 31 organizata përfituese të granteve të mbështetura nga FGK-ja deri me 31 dhjetor 2017 për këtë vit kanë përfshirë 398 gra në proceset vendimmarrëse, përmes takimeve me autoritetet lokale dhe avokimit. Për disa gra, kjo ishte hera e parë që ato ishin përfshirë në proceset vendimmarrëse.

Brenda kuadrit të institucionalizimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGj), RrGK-ja ka trajnuar dhe mentoruar 17 zyrtare në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), 13 zyrtare në Ministrinë e Diasporës (MeD) dhe 15 zyrtare në Komunën e Prishtinës lidhur me përfshirjen e BPGJ-së në procesin e planifikimit të buxhetit të tyre. Kjo mund të kontribuojë në planifikimin e buxhetit i cili do t'i shërbejë më mirë nevojave dhe përparësive të grave.

Si rezultat i takimeve të mëparshme me Zyrtaret për Barazi Gjinore (ZBGj) dhe bazuar në mësimet e nxjerra nga përvojat e tyre, RrGK ka draftuar kurrikulën e re për ZBGJ-të. Kjo është bërë pjesë e kurrikulës që zbatohet nga Instituti Kosovar i Administratës Publike (IKAP).



Rritja e vetëdijesimit përrëndësinë e përafrimit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe ligjeve zgjedhore

Këtë vit, RrGK-ja ka vazhduar të avokojë për rëndësinë e përafrimit të Ligjit për Barazinë Gjinore me ligjet e tanishme zgjedhore. Kjo është bërë përmes publikimit të dokumentit të politikave [*Progresi i Kosovës në përafrimin e ligjeve të saj me ligjet e BE-së mbi barazinë gjinore*](#), të cilin e kanë shkruar dy avokate të njohura evropiane dhe eksperte të barazisë gjinore, Sylvia Cleff le Divellec dhe Katharina Miller, me kërkesë të RrGK-së, të cilin e publikuan me 8 nëntor. Dokumenti ka vlerësuar masën në të cilën ligjet e Kosovës janë përafruar me Acquis-in për Barazi Gjinore të [*Bashkimit Evropian \(BE\)*](#). Ekspertet kanë identifikuar mangësitë dhe kanë dhënë rekomandime për harmonizimin më të mirë të ligjeve të Kosovës me Acquis-in për Barazi Gjinore të BE-së. Disa nga rekomandimet kryesore përfshijnë:

- Kosova duhet të mbledhë rregullisht të dhënat në lidhje me hendekun gjinor në paga në mënyrë që të lehtësojë monitorimin e saj;
- Ligji i Punës kërkon disa ndryshime për të përmbushur standardet e BE-së;
- Përcaktime specifike për ngacmimin seksual dhe dhunën në familje duhet të përfshihen në [*Kodin Penal*](#); dhe
- Sanksionet në [*Ligjin për Barazi Gjinore*](#) nuk janë mjaftueshëm të ashpra për parandalimin e shkeljeve të Ligjit dhe në këtë mënyrë nuk janë mjaftueshëm bindëse, siç parashihet me acquis-in për barazi gjinore të BE-së.



Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjimore mbetet i dobët dhe duhet të ndërmerren hapa të mëtejshëm siç është rekomanduar në Dokumentin e Politikave për të adresuar këtë.

Gratë në politikë, gratë që drejtojnë OJQ dhe votueset komunikojnë dhe bashkëpunojnë më shumë rreth çështjeve që gratë i konsiderojnë prioritete

Përmes anëtareve të Lobit dhe RrGK-së, gratë nga sfera politike, shoqëria civile dhe gratë votuese kanë bashkëpunuar rreth çështjeve të rëndësishme për to gjatë vitit 2017. Lobi në bashkëpunim të ngushtë me gratë votuese nga komunat e tyre avokojnë në çështjet që gratë i konsiderojnë prioritete.

Avokimi i iniciuar për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet

Në vitin 2017, RrGK ka avokuar në shumë procese politike dhe politika për prioritetet e grave. RrGK ka marrë pjesë në një numër të grupeve punuese qeveritare dhe/ose ka ofruar komente në ligjet dhe politikat që do të ndikojnë në jetët e grave dhe vajzave. RrGK ka përkrahur përfshirjen e perspektivës gjinore, duke analizuar draftet e politikave publike (ligjeve, udhëzimeve administrative, strategjive, planeve të veprimit) nga një perspektivë gjinore dhe duke vlerësuar ndikimin potencial që ato mund të kenë në burra, gra, vajza dhe djem. Politikat të cilat RrGK i ka ri-shikuar, gjatë vitit 2017, nga një perspektivë gjinore dhe ka ofruar të dhëna përfshinin:

1. Matriksi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) për vitin 2017;
2. Draft Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2017-2019;



3. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-249 për Sigurimet Shëndetësore;
4. Projekt Kodi i Mirësjelljes për Forcën e Sigurisë së Kosovës (Mfsk) Nr.02/2017;
5. Draft Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve;
6. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2018 (*Raporti i Progresit për Kosovën*);
7. Amandamentet për Draft Kodin Penal të Kosovës;
8. Draftimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2017-2021 të Agjencionit për Barazi Gjinore në Kosovë;
9. Harmonizimi i Ligjit të Punës me Direktivat e BE-së.

Përmes FGK-së, RrGK gjithashtu ka mbështetur 61 iniciativa avokuese nga sdymbëdhjetë anëtare të RrGK-së, të detajuara në seksionin e mëparshëm të këtij raporti.

Përmirësimi i institucionalizimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Kosovë

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor është i rëndësishëm jo vetëm për rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, por edhe për ndarjen efikase dhe të barabartë të fondeve publike. Prandaj, RrGK, është duke u bazuar në përvojat pozitive të kaluara, duke përdorur metodën e zhvilluar nga GIZ dhe ekspertizën ndërkombëtare, që të punojë drejtë institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë.



Zgjerimi i kapaciteteve të zyrtarëve të synuar për zbatimin e BPGJ

Gjatë vitit 2017, dy ministri dhe një komunë janë asistuar nga RrGK për të përfshirë BPGJ-në në procesin e planifikimit të buxhetit të tyre. Në total janë trajnuar dhe mentoruar 45 zyrtarë në nivel qendror dhe lokal. Njerëzit që janë trajnuar dhe/ose mentoruar përfshijnë zyrtarë të financave, shefa të financave në drejtoritë komunale, sekretarë të përgjithshëm të ministrive, përfaqësues të departamenteve ministrore, divizioneve dhe agjencive dhe ZBGJ-të, të cilët kanë fituar njohuri dhe kapacitete të reja. Nga 45 zyrtarë, 17 (16 gra dhe 1 burra) janë mentoruar dhe trajnuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), 13 (6 gra dhe 7 burra) në Ministrinë e Diasporës. Ndërsa në komunën e Prishtinës janë trajnuar 15 zyrtarë, 7 gra dhe 8 burra.



Gjithashtu, mbështetur nga FGK, Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” zhvilloi iniciativën “Ngritja e pozitës së Gruas në proceset e paqe-bërjes dhe buxheti gjinor” duke trajnuar 41 zyrtarë nga komuna e Ferizajit dhe e Klokotit. Përveç trajnimeve, zyrtarët përfituan njohuri edhe përmes shkëmbimit të përvojave të cilat janë bërë me zyrtarë nga komuna e Kamenicës. Si rezultat i kësaj iniciative komuna e Ferizajit bëri hartimin e politikave gjinore. Kjo komunë tani është në fazën e planifikimit të kornizës afatmesme si dhe analizave gjinore në sferën e punësisë.

Rekomandime konkrete për përmirësimin e BPGJ janë prezantuar tek zyrtarët përkatës me qëllim të institucionalizimit të BPGJ

Për shkak të avokimit dhe mentorimit, sukseset në vazhdim janë arritur drejt institucionalizimit të BPGJ-së:

Në bazë të mbështetjes që RrGK ka ofruar për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Diasporës në përfshirjen e një perspektive gjinore në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), të dy Ministrinë kanë integruar të gjitha ndryshimet e propozuara nga RrGK në këtë dokument të rëndësishëm buxhetor.

Gjithashtu, gjatë publikimit të raporteve mbi analizën gjinore të buxhetit dhe shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, rekomandimet e dalura nga raporti janë prezantuar në praninë e një publiku divers, përfshirë aty edhe mediat kombëtare dhe zyrtarë të ministrive përkatëse. Rekomandimet janë mirëpritur nga përfaqësuesit e të dy ministrive.

Përveç kësaj, janë publikuar versione të përditësuara të broshurave të BPGJ-së, të cilat kanë nisur të përdoren nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike në një kurrikulë të re për shërbyesit civilë lidhur me BPGJ – ‘Udhëzues praktik për përdoruesit: Buxheti i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal’ dhe ‘Udhëzues praktik për përdoruesit: Buxheti i përgjegjshëm gjinor në nivel qendror’.



PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR CILËSOR

Objekti afatgjatë i këtij programi është që gratë të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor dhe me kosto të përballueshme. RrGK ka bërë përparim drejt arritjes së qëllimit sikurse e ilustrojnë rezultatet e mëposhtme.

Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor

Në shkurt të këtij viti RrGK publikoi raportin “Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë”. Pas publikimit të këtij raporti, RrGK së bashku me anëtarët krijuan Grupin Avokues për Shëndetësi (GASH). Janë mbajtur disa takime me anëtarët e grupit, ku edhe janë ndarë fushat në të cilat do të avokohet. Pjesë e këtij grupi janë: RrGK, Shoqata e Mamive të Kosovës, Shoqata Iniciativa e Grave dhe Zyrtarja për Barazi Gjimore në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ndërkaq në tetor, anëtarët e GASH u takuan me Ministrin e posa emëruar të shëndetësisë, z. Uran Ismaili, ku u diskutua për mbylljen e materniteteve nëpër Komuna dhe ndikimin negativ që kjo ka në qasjen e grave në kujdes shëndetësor; rëndësinë e mamisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në maternitete dhe përcaktimi i përshkrimit të punës së mamisë; dhe afërsia e komunitetit me ofruesit e shërbimeve shëndetësore përmes decentralizimit.




Më shumë gra dhe vajza të vetëdijesuara për të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e qasjes në kujdes shëndetësor; më shumë gra të vetëdijesuara si të zbulojnë shenjat e kancerit

Të mbështetura nga FGK-ja, Gruaja Bashkëkohore ngrii vetëdijen e 52 grave dhe vajzave, Foleja 300 gra dhe vajza si dhe Aksioni për Nëna dhe Fëmijë kanë bërë ngritjen e vetëdijes tek 263 gra dhe vajza në komunën e Prizrenit; Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar tek 59 persona të verbër dhe 40 anëtarë të tyre familjarë në komunën e Rahovecit; dhe Organizata Bliri tek 263 gra dhe vajza në komunën e Drenasit (për më shumë informacion shih seksionin më lartë “Ndërtimi i Kapaciteteve të RrGK-së”).

Të ketë hulumtim për dokumentimin e shkeljes së të drejtave të grave në kujdes shëndetësor

Në vitin 2016 RrGK realizoi hulumtimin mbi qasjen e qytetarëve të Kosovës në kujdesin shëndetësor. Raporti u publikua në shkurt të vitit 2017 i titulluar “Qasja në Kujdesin Shëndetësor në Kosovë”, ku u dokumentua se gratë në zonat rurale ballafaqohen më tepër se sa burrat apo gratë në zonat urbane, me pengesa financiare, kulturore dhe marrëdhënie pacient-ofrues të shërbimit në qasjen tek shërbimi shëndetësor. Gratë boshnjake dhe turke kanë më tepër tendencë të ballafaqimit me pengesa se burrat e kombësisë së njëjtë, dhe dukshëm më tepër se gratë dhe burrat shqiptarë. Gratë dhe burrat rom, ashkali, egjiptas, dhe goran ballafaqohen më tepër me pengesa gjeografike, financiare dhe kulturore në qasjen në kujdes shëndetësor.



Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ka qenë të hetohet çfarë barriera ekzistojnë në qasjen e kujdesit shëndetësor dhe nëse ato janë të ndryshme për burrat dhe gratë. Më shumë se 1,300 persona janë anketuar si pjesë e hulumtimit të realizuar në verën e vitit 2016 si dhe janë intervistuar 109 punëtorë shëndetësorë dhe njohës kyç të çështjes.. Studentët nga Kolegji i Dartmouth-it, Universiteti i Prishtinës dhe shumë vullnetarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë kanë ndihmuar me punën në terren dhe analizat.

Më shumë zyrtarë publik, gra, vajza dhe burra janë në dijeni për të drejtën e grave për kujdes shëndetësor dhe shkeljet e të drejtave të tyre

RrGK, edhe këtë vit vazhdon të jetë anëtare e Koalicionit K10 për Shëndet dhe të Drejta Riprodhuese. Gjatë këtij viti është draftuar Strategjia avokuese e këtij Koalicioni. Poashtu, janë mbajtur disa diskutime të hapura me qytetarë me tema të ndryshme në lidhje me të drejtat dhe shëndetin riprodhues.

Koalicioni K10 u themelua në vitin 2015, dhe përbëhet nga RrGK, Aksioni për Nënë dhe Fëmijë; Asociacioni për Edukim dhe Zhvillim të Shëndetësisë; Artpolis; Shëndet për të Gjithë; Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit – JetaVita; Fondi Kosovar për Popullsi; Shoqata Kosovare për Promovimin, Avancimin dhe Mbrojtjen e Shëndetit të Adoleshentëve; Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatar; dhe Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë.



Më shumë gra të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor

Si rezultat i iniciativave të përkrahura nga FGK, Bliri avokoi suksesshëm tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunën e Drenasit si dhe siguroi shërbime gjinekologjike dhe mamografi pa pagesë për 28 gra. Gjithashtu, Foleja avokoi suksesshëm tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunën e Prizrenit si dhe siguroi shërbime gjinekologjike pa pagesë për 30 gra të komunitetit rom.

Ndërkaq, GASh ka avokuar me sukses në Ministrinë e Shëndetësisë për: Mbylljen e materniteteve nëpër Komuna dhe ndikimin negativ që kjo ka në qasjen e grave në kujdes shëndetësor; Rëndësia e mamisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në maternitete dhe përcaktimi i përshkrimit të punës së mamisë; dhe Afërsia e komunitetit me ofruesit e shërbimeve shëndetësore përmes decentralizimit.



Gratë dhe vajzat më të vetëdijshme për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

Më 28 tetor, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit (QKLKGJ) Jeta Vita, organizoi programin e tyre tradicional, kulturor dhe informues, ku mbledhi qindra qytetarë, përfshirë edhe anëtarët e stafit të RrGK-së dhe organizata tjera, si dhe përfaqësues të lartë shtetëror, të cilët marshuan së bashku me moton e organizatës: “Zbulimi i Hershëm = Mbijetesë” për të shprehur solidaritetin dhe për të rritur sensibilizimin për kancerin e gjirit në shoqërinë kosovare.

Të mbështetura nga FGK-ja, për t'i informuar gratë dhe vajzat më shumë për të drejtat e tyre organizatat anëtare të RrGK ndërmorrën këto iniciativa: Gruaja Bashkëkohore informoi 52 gra dhe vajza nga komuna e Prizrenit; Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjen 230 gra dhe vajza nga komuna e Gjakovës; ndërsa Bliiri 263 gra dhe vajza nga komuna e Drenasit; Aksioni për Nëna dhe Fëmijë punoi në komunën e Prizrenit duke informuar 48 vajza nga komuna e Prizrenit; si dhe Foleja në komunën e Prizrenit informoi 167 gra dhe vajza. Organizata Artpolis në partneritet me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave organizuan seanca vetëdijesuese për 130 gra dhe vajza nga komuna e Prishtinës dhe Drenasit.



Më shumë gra avokojnë për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor cilësor

Me mbështetjen e FGK, janë ndërmarrë shtatëmbëdhjetë iniciativa të avokimit nga organizatat anëtare të RrGK-së: Gruaja Bashkëkohore avokoi tek Ministria e Shëndetësisë përmes letrës publike dërguar Ministrit Uran Ismaili. Kërkesa përmbante rekomandime të dalura për përmirësimin e qasjes shëndetësore për gra dhe vajza në komunën e Prizrenit, të dalura nga aktivitetet dhe tryezat e organizuara nga kjo shoqatë. Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes avokoi për hapjen e zyrës këshilluese shëndetësore për vajza në komunën e Gjakovës.

Bliri avokoi suksesshëm tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunën e Drenasit si dhe siguroi shërbime gjinekologjike dhe mamografi pa pagesë. Artpolis në partneritet me Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave avokuan tek Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për futjen e edukimit seksual në planprogramet mësimore për shkollat e mesme. Aksioni për Nëna dhe Fëmijë avokoi suksesshëm për hapjen e qendrës "Klasat për nëna" brenda Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren. Ato gjithashtu avokuan për futjen e temës së depresionit të paslindjes në kurrikulën edukative në Klasat për Nëna. Foleja avokoi suksesshëm tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në komunën e Prizrenit si dhe siguroi shërbime gjinekologjike pa pagesë.



JETA PA DHUNË ME BAZË GJINORE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë një jetë të lirë nga dhuna me bazë gjinore. RrGK ka bërë progres drejt përmbyshjes së këtij qëllimi, siç e ilustronjë edhe të arriturat dhe rezultatet në vazhdim.

Përmirësohet zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë

Në fund të vitit 2016, Ministria e Drejtësisë themeloi grupin punues, i cili draftoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit në Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020. Kjo strategji u publikua në maj të këtij viti dhe në të u përfshinë mbi 70% e rekomandimeve të raportit “Mjaftë më me arsytime” të RrGK-së. RrGK gjatë këtij viti ka bashkëpunuar me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) për të monitoruar zbatimin e kornizës ligjore për dhunë në familje.

Poashtu, gjatë këtij viti, RrGK ka ndihmuar familjen e të ndjerës Zejnepe Berisha e cila u vra nga bashkëshorti i saj, si pasojë e dhunës në familje. Vrasësi u dënua me një dënim minimal, andaj RrGK angazhoi një avokate për ta ndihmuar familjen e së ndjerës, me ç’rast, vrasësit nga dënimi fillestar prej 12 vitesh, iu shqipëtua dënimi me 17 vite burg.

Edhe këtë vit, RrGK vazhdon të jetë pjesë e Grupit për Siguri Gjinore, grup i cili është i përbërë nga palët e shumta të interesit me të cilat RrGK ka bashkëpunuar në avokim për të përmirësuar zbatimin



e kornizës përkatëse ligjore. Kjo përfshinë avokimin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020.

RrGK këtë vit ka qenë e ftuar nga Komiteti i Parlamentit Evropian për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore (FEMM) dhe Nënkomiteti për të Drejtat e Njeriut (DROI) ku avokoi tek parlamentarët e BE-së për mbështetje, në mënyrë që të sigurohet që trajtimi i dhunës kundër grave, në të gjitha format e saj, të bëhet prioritet politik.

Në shtator të këtij viti RrGK ka dërguar propozimin për përfshirjen e dhunës në familje dhe ngacmimin seksual si vepra të veçanta penale në Kodin Penal të Kosovës.

Ekzistojnë raportet që monitorojnë zbatimin e kornizës ligjore të dhunës në familje, si dhe është rritur ndërgjegjësimi rreth kornizës ligjore dhe shtrirjes së dhunës në familje

RrGK ka vazhduar përpjekjet e saj në ngritjen e vetëdijes tek qytetarët në raportimin e dhunës në familje dhe në kornizën ligjore që iu ndihmon atyre të adresojnë dhunën në familje. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me BIRN, RrGK ka monitoruar 179 raste të raportuara të dhunës në familje në institucionet vendore, përfshirë këtu në: polici, Qendra për Punë Sociale, prokurori, gjykatat dhe Mbrojtësit e Viktimave, në 7 rajone të Kosovës. Gjatë këtij monitorimi është vërejtur se në përgjithësi, ka përmirësim nga disa institucione në zbatimin e kornizës ligjore.

Tutje, gjatë këtij viti RrGK ka intervistuar mbi 80 përfaqësues të po këtyre institucioneve, për të parë për së afërmi se si është përmirësuar adresimi i rasteve të dhunës në baza gjinore. Raporti hulumtues do të publikohet në janar të vitit 2018.



Institucionet dhe akterët e tjerë janë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjor për dhunën në familje

Edhe gjatë këtij viti, RrGK ka mbajtur takime me përfaqësues të institucioneve për të avokuar në lidhje me zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje. Janë mbajtur takime me Prokurorë, Drejtorinë e Policisë, Departamentin për Punë Sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me Udhëheqësin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe me akterë të tjerë relevant. Këto takime kanë pasur për qëllim të mbështesin institucionet në përmirësimin e punës së tyre në aplikimin e kornizës ligjore për dhunën në familje.

Anëtarët e RrGK janë angazhuar për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

RrGK vazhdimisht ka bashkëpunuar me disa nga anëtarët e saja, përveç aktorëve tjerë, në avokimin për zbatimin e kornizës ligjore. RrGK do të vazhdojë të përfshijë më shumë anëtare në këtë avokim. Për më tepër, disa anëtare të RrGK-së u përfshinë në avokim për zbatimin e kornizës ligjore nëpër komunitat e tyre, veçanërisht gjatë 16 Ditëve kundër Dhunës ndaj Grave.



Performanca dhe cilësia e shërbimeve të strehimoreve është ngritur, veçanërisht në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integritimit

RrGK do të vazhdojë të avokojë për financim të qëndrueshëm për strehimoret si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, si dhe për përmirësim të monitorimit të cilësisë së shërbimeve.

Është përmirësuar ndërgjegjësimi dhe vëmendja në radhët e zyrtarëve dhe qytetarëve lidhur me trajtimin e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

Përparim është arritur sikurse tregohet në rezultatet në vazhdim.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre, duke përfshirë meshkujt

RrGK ka pasur më shumë se 116 paraqitje me shkrim, TV dhe platforma të medie sociale, në mënyrë që të shpërndajë mesazhin për dhunën në familje dhe të ngrisë vetëdijen ndër qytetarët për temën e dhunës në familje.

Poashtu, gjatë këtij viti RrGK ka filluar fushatën “Nuk Ka Arsytim” (#NukKaArsytim) në mediat sociale (Facebook, Instagram dhe Twitter) me qëllim të ngritjes së vetëdijes për format e ndryshme të dhunës në familje, si dhe mbi mënyrat e raportimit të dhunës në familje dhe ngacmimit seksual.



Hartohen politikat dhe përmirësohen procedurat për trajtimin e ngacmimit seksual

RrGK ka dërguar propozimin për amandamentimin për përfshirjen e ngacmimit seksual si vepër e veçantë penale në kaudër të ndryshimeve të Kodit Penal. Ky propozim ka për qëllim përmirësimin e procedurës dhe trajtimit të ngacmimit seksual në pajtim me seriozitetin dhe peshën e kësaj veprë. Për më tepër, komentet me shkrim të RrGK-së për të përfshirë në mënyrë të qartë ngacmimin seksual në Kodin e Mirësjelljes për Forcën e Sigurisë së Kosovës janë pranuar dhe përfshirë në Kod.

Organizata Artpolis përpiloi Manualin e Politikave për adresimin e ngacmimit seksual në Universitete Publike. Poashtu, Qendra Kosovare për Studime Gjinore ka hartuar “Politikat kundër ngacmimit seksual në vend të punës në Kosovë”.

Koordinimii themeluarnëmesin e OSHC-ve tëudhëhequra nga gratë, institucioneve publike, si dhe vendeve të tjera tëpunës në drejtim të instalimit të mekanizmave të përmirësuar për raportimin dhe hetimin e rasteve tëngacmimit seksual

Puna e “Artpolis” me universitetet publike është duke kërkuar për të përmirësuar përgjigjen e tyre ndaj ngacmimit seksual. Poashtu edhe politika e hartuar nga QKSGj kontribuon në mbrojtjen e barazisë gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë në Kosovë duke ndaluar çdo formë të ngacmimit seksual që rrezikon integritetin personal të të gjithë të punësuarëve në Kosovë.



RrGK në bashkëpunim me Girls Coding Kosova kanë mbajtur trajnime për policinë, drejtorinë e planifikimit hapësinor dhe Zyrën për Barazi Gjinore të Komunës së Prishtinës, në lidhje me përdorimin e platformës “Ec Shlirë” si dhe kornizën ligjore vendore për ngacmimin seksual, me qëllim të përmirësimit të raportimit dhe të hetimit të rasteve të ngacmimeve seksuale.



Përmirësohet mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

RrGK ka mbetur anëtare aktive e grupit punues të formuar nga MPMS si pasardhës i Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë, që ishte nën udhëheqjen e Presidentes së Kosovës. RrGK gjithashtu ka vazhduar me avokimin e saj në lidhje me themelimin e Komisionit zyrtar që do të rishikojë aplikimet për dëmshpërblim dhe mbështetjen e qeverisë për gratë e mbijetuara, si dhe të Sekretariatit të tij.



Përgjatë vitit 2017, RrGK ka marrë pjesë në takimet e bashkërenditura të MPMS me organizatat që punojnë për të mbështetur të mbijetuarat të cilat kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës. Këto takime të rregullta në MPMS kanë mundësuar bashkërendimin në mes të organizatave dhe të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Në konferencën e organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT) me temë "Trajtimi i stigmës për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë" më 14-15 shtator 2017, RrGK së bashku me QKRMT, Medica Kosova, Medica Gjakova dhe Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) arriti në përfundimin se çështja urgjente lidhur me të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës është aprovimi i buxhetit për të vazhduar me dhënien e dëmshpërblimeve për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës. Prandaj, këto organizata shkruan një letër të përbashkët për të adresuar çështjen, duke i kërkuar Qeverisë që të vazhdojë me miratimin e buxhetit. Kjo iniciativë avokuese ishte e suksesshme pasi që në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi shqyrtimin e buxhetit për 2017, duke ndarë buxhetin për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Tani, pensioni për këto gra do të jetë 230€ në muaj dhe perioda e aplikimit fillon në janar 2018.



Është përmirësuar përfshirja e RrGK dhe e anëtareve të saj në proceset për sigurimin e mbështetjes institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Gjatë vitit 2017, RrGK kontribuoi në fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës përmes projektit “Përkrahja e grave të mbijetuara të dhunës seksuale”, i cili u përkrah nga UN Women si pjesë e Projektit Global të tyre “Ndjeshmëria gjinore në drejtësinë në tranzicion”, financuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Përmes këtij projekti RrGK ndau në total 180,487.46€ për katër organizatat anëtare të RrGK-së të specializuara në punën me gratë e mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës: 1. Medica Gjakova; 2. Medica Kosova; 3. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT); dhe 4. Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG). Këto organizata më pas ndanë mikro-grante për 177 gra të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës, si dhe përkrahje psikologjike. Përmes këtij projekti, RrGK në koordinim me këto 4 organizata të saj anëtare ofroi edhe avokim të përbashkët për të përfaqësuar më gjerësisht interesat e tyre tek zyrtarët qeveritarë dhe qytetarë; dhe koordinim të rregullt të akterëve kyç që punojnë në përkrahjen e grave të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës.



MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike.

Më shumë gra sigurojnë punësim

RrGK ka bërë përparim drejt këtij objekti afatgjatë që gratë të kenë qasje të barabartë në mundësi punësimi në Kosovë. Një arritje e madhe në këtë drejtim është krijimi i Forumit Ekonomik të Grave dhe përfshirja e tij në Këshillin Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës në vitin 2017. RrGK si bashkëthemeluese e këtij forumi, ka ndërmarrë hapa drejt krijimit të një strategjie avokuese të përgjithshme e cila e ka si synim përmirësimin e disa politikave kyqe për punësimin e grave në Kosovë.

RrGK, poashtu gjatë këtij viti, ka qenë pjesë e grupit punues për amendamentimin e Ligjit të Punës të Kosovës ku posaqërisht ka avokuar për ndryshim të neneve që kanë të bëjnë me pushimin e lehonisë, gjdhënjen dhe krijimin e një dispozite e cila e përcakton një pushim të përbashkët prindëror.

Institucionet dhe akterët kryesor më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit gjinor në vendin punës në Kosovë dhe mënyrat për t'i adresuar ato dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe të sektorit privat për punësimin e grave

RrGK si pjesë të aktiviteteve avokuese gjatë procesit të amendamentimit të Ligjit të Punës të Kosovës (shih më lartë), përmes diskutimeve të frytshme ka arritur të rrisë vetëdijen e përfaqësuesëve të



institucioneve dhe të sektorit privat të ndryshëm në lidhje me diskriminim gjinor në vendin e punës dhe punësimin e grave.

Më shumë mundësi të përballueshme në dispozicion për përkujdesje të fëmijëve

Në vitin 2016, RrGK në bashkëpunim me Swiss Contact programin PPSE publikoi raportin “Kush kujdeset?”, ku u paraqitën disa forma alternative të ngritjes së mundësive të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, PPSE ndau grante përkrahëse për OJQ-të, me synim të ngritjes së mundësive alternative të kujdesit për fëmijë dhe të moshuar. Përfituese ishte edhe organizata anëtare e RrGK, SHE-ERA, e cila ka trajnuar 3 burra dhe 87 gra të cilët fituan njohuri rreth kujdesit të fëmijëve dhe të moshuarve. Ky projekt kishte për qëllim të kontribuojë në ngritjen e mundësive të punësimit për gratë si dhe të ju krijoj grave lehtësira në ndarjen e barrës së kujdesit të fëmijëve dhe të moshuarve.



Më shumë gra kanë qasje në trashëgimi dhe pronësi

Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave në partneritet me Qendrën për Promovimin e Familjës së Shëndoshë	Fuqizimi i të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës për realizimin e të drejtave ligjore	7,305.00€	Janë mbajtur takime me gra dhe burra ku janë informuar në lidhje me procedurat ligjore dhe mekanizmat për statusin e viktimës civile të luftës. Është ofruar asistencë dhe mbështetje në lidhje me plotësimin e aplikacionit për përfitimin e statusit të viktimave civile.	Janë informuar 120 gra dhe burra në lidhje me të drejtat specifike që garantohen me ligj (të drejtat për pension, të drejtat për strehim e rehabilitim, si dhe të drejtat për arsimim). 120 gra janë trajnuar në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e statusit të viktimave civile, të cilat gra janë të gatshme për të plotësuar formularin për aplikim. Krahas kësaj, janë dokumentuar 50 histori personale për krimet e ndodhura gjatë luftës në Kosovë.
Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar	Vetëdijesimi për përkrahje dhe mbështetje të personave të verbër dhe	3,753.50€	Janë mbajtur takime me përfaqësues të nivelit lokal dhe qendror për krijimin e mundësisë së ofrimit të mbështetjes	Kanë avokuar me sukses tek Drejtoria e Arsimit në Komunën e Rahovecit, ku 4 fëmijë të verbër u kyçën në Shkollën Speciale për të Verbër në Pejë, dhe 1 fëmijë me të pamë të dobësuar në

	personave me të pamurit të dobësuar		komunale për personat e verbër dhe me të pamë të dobësuar në sferën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit hapësinor, punësimit, aftësimin profesional dhe barazisë gjinore. Po ashtu, janë mbajtur takime dhe seanca këshilluese me familjarët e personave të verbër dhe me të pamë të dobësuar me qëllim të ngritjes së vetëdijes rreth përkrahjes së këtyre personave dhe trajtimit të barabartë në familje të personave të verbër.	shkollimin e rregullt fillor, si dhe u siguruan klasat për zhvillimin e kurseve për mësim të shkrim-leximit sipas alfabetit të Brailleit. Po ashtu, është avokuar me sukses edhe tek Drejtoria e Urbanizmit në këtë komunë, ku komunikacioni rrugor për të verbërit është futur në planin urbanistik për vitin vijues. Më tej, 46 persona të verbër nga Komuna e Rahovecit me fshatra janë informuar rreth të drejtave të tyre në fushat shëndetësore, sociale dhe juridike si dhe 50 familjarë të këtyre personave u informuan për trajtim të mirëfilltë të të verbërve dhe trajtim të barabartë të tyre me anëtarët e tjerë të familjes.
Partners Kosova	Avokimi i grave për të drejtat e tyre pronësore	3,532.00€	Janë mbajtur prezantimet një ditore si dhe prezantimet e përbashkëta me grupe të	Janë informuar 85 gra dhe burra në lidhje me të drejtat e tyre pronësore si dhe rrugët ligjore që duhet ndjekur në rastet e kërimit të ndarjes së pronës

	dhe ato të trashëgimisë		grave nga Komuna e Drenasit dhe ajo e Mamushës. Në takimet e përbashkëta, përveç përfituesve të projektit, morën pjesë edhe përfaqësues nga institucionet relevante për të drejtën në pronë dhe trashëgimi. Gjithashtu, Partners Kosova, në baza mujore ka bërë monitorimin e zyrave të ofiqarisë në kuadër të këtyre komunave,	dhe trashëgimisë. Janë bërë 8 monitorime në zyrat e ofiqarive dhe të kadastrit, për të parë se sa prona po regjistrohen në emër të grave dhe sa po respektohet afati ligjor për regjistrimin e pronës.
Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës	Më shumë të drejta për gratë e verbëra	3,370.00€	Është mbajtur fushata për ngritjen e vetëdijes së personave të verbër dhe familjarëve të tyre në lidhje me të drejtat e personave të verbër në	Janë informuar 20 gra dhe burra në lidhje me të drejtat e tyre në arsim të cilat i kanë të garantuara me ligjin 04/L-092.

			arsim. Gjithashtu, janë mbajtur takime avokuese dhe tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues nga MASHT-i, si dhe asambleistët komunal. Poashtu, KGVK-ja mbajti një debat në media lidhur me këtë çështje, si dhe punoi broshura në alfabetin e Braille-it.	
Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut	Gratë vendim-marrëse	2,175.00€	Janë mbajtur takime me liderët e partive politike, të cilët do të ndajnë listën e grave që do të kandidohen në zgjedhjet lokale 2017. Janë mbajtur trajnime në temat: Komunikimi, Debat, Prezantimet publike, si dhe Udhëheqja. Pas	Janë informuar dhe trajnuar 14 kandidatë të reja në lidhje me aftësitë udhëheqëse gjatë fushatës zgjedhore, të organizuar gjatë muajit tetor. Më tej, 4 kandidatë të reja nga lista zgjedhore në vitin 2017, pjesëmarrëse të këtyre trajnimeve, u bënë anëtare të Kuvendit Komunal në Mitrovicën Jugore.

			trajnimeve, kandidateve iu mundësuan edhe prezantimet publike.	
Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës	Kujdesi shëndetësor është i mirë atëherë kur ka qasje për të gjithë	2987.50€	Do të mbahen takime ligjëruese, si dhe do të organizohen vizita shëndetësore për gra me nevoja të veçanta, të udhëhequra nga specialistët nga gjinekologjia, urologjia, kardiologjia dhe stomatologjia. Gjatë takimeve ligjëruese, pjesëmarrësve do t'i ndahen pyetësorët në lidhje me kënaqshmërinë dhe nevojat e tyre rreth shërbimeve shëndetësore. Pas analizës së tyre, do të organizohen takimet	U mbajtën takime të rregullta mujore me 20 gra dhe vajza, ku u diskutuan tema të ndryshme mbi shqetësimet dhe pengesat që ato kishin. Njëheri, u organizuan katër takime, ku specialistët e shëndetësisë mbajtën ligjerata. U përpiluan dhe pyetësorë të cilët shërbenin për mbledhjen e informatave më specifike mbi nevojat e shëndetit parësor të personave me distrofi muskulare dhe nevojat e familjarëve të tyre. Këto informacione shërbyen për të nxjerrë një raport dhe rekomandime më specifike, që më pastaj i janë dorëzuar institucioneve. U avokua tek përfaqësuesit e drejtorive shëndetësore, barazisë gjinore dhe institucioneve të nivelit lokal për përmirësimin e qasjes në shërbimet shëndetësore.

			avokuese tek institucionet përgjegjëse.	
Vita Jeta	Diabeti tek të moshuarit	2,741.10€	Do të mbahen ligjëratat mbi temat: diabeti, ushqimi, terapia, higjiena e personave me diabet., vetë-kontrollimi dhe vetëdijesimi për pjesëmarrësit nga grupmoshat 50-80 vjeç nga fshatrat Matiçan, Kolovicë, Bërnice, Shashkovc dhe Mramor të Komunës së Prishtinës. Përveç ligjëratave, do të bëhet dhe matja e glukozës me glukometër për rreth 400 persona nga fshatrat e lartpërmendura. Po ashtu, në bazë të të	284 gra dhe 43 burra janë informuar mbi temat e ndryshme si: diabeti, ushqimi, terapia, higjiena e personave me diabet, vetë-kontrollimi. Pas secilit leksion, të gjithë pjesëmarrësve i'u është bërë matja e glukozës me qëllim të njohjes, ndërgjegjësimit dhe monitorimit të kësaj sëmundje. U avokua tek Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunë e Prishtinës, për t'i mundësuar grave dhe burrave kujdes shëndetësor sa më cilësor e në veçanti shërbimet për diabet.

			dhënave për nevojat e përfituesve do të avokohet që të ju mundësohet një trajtim mjekësor më i specializuar në ambulancat përkatëse të këtyre zonave.	
Qendra për Fuqizimin e Gruas	Fuqizimi ekonomik i grave - nënave kryefamiljare	2,780.00€	Do të përpilohet libri me rreth 40 storie të nënave kryefamiljare në bazë të të cilit në tryezë të rrumbullakët do të avokohet tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, deputetët, gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj. për reagim më të shpejtë të sistemit të drejtësisë në zbatimin e Ligjit për Familje, i cili	U avokua tek kryetarët dhe zyrtarët e këshillit gjyqësor, gjykatave etj. duke kërkuar shqyrtimin e rasteve për alimentacion dhe pronësi, njëheri duke adresuar të gjitha shqetësimet dhe padrejtësitë që u janë bërë grave dhe fëmijëve të tyre. U botua një libër tregues i grave kryefamiljare, që kërkuar këto të dretja. Ky libër është shkruar pas 24 intervistave me këto gra. Nëpërmjet këtyre tregimeve, të cilat janë të shënuara me initiale për të ruajtur identitetin, krijohet një pamje e qartë se

			garanton të drejtat e grave, më konkretisht shqyrtimin e lëndëve për alimentacion dhe pronë, të cilat do të përmirësojnë dukshëm situatën financiare dhe atë të banimit për gratë kryefamiljare dhe fëmijët e tyre.	si trajtohen çështjet gjyqësore dhe problemet që hasin gjatë këtij rrugëtimi.
Luna	Shëndeti i grave dhe liria e lëvizjes	2,987.50€	Do të mbahen punëtori me gra dhe vajza të komunitetit serb dhe romë në lidhje me rëndësinë dhe të drejtat e tyre shëndetësore, me fokus të veçantë tek sëmundjet kancerogjene. Përveç trajnimeve, gjatë kësaj iniciative do të avokohet për dy çështje shumë të rëndësishme	68 gra dhe vajza u njoftuan rreth kancerit të gjirit dhe të qafës së mitrës, për rëndësinë e vetë-ekzaminimit dhe mbështetjes së grave të prekura nga këto sëmundje. U ofruan konsultime individuale lidhur me problemet e tyre shëndetësore. Më tej, u avokua për ofrimin e shërbimeve gjinekologjike në qendrat e mjekësisë familjare të fshtarave si: Prilluzhe, Plemetin dhe Gojëbulë. Njëheri, avokuan tek Komuna e

			për gratë e fshatrave Prilluzhë, Gracë dhe Plemetinë të Komunës së Vushtrrisë: 1) Ofrimin e shërbimeve gjinekologjike në qendra të mjekësisë familiare si dhe 2) Sigurimin e transportit nga këto fshatrat deri tek qyteti.	Vushtrrisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim për sigurimin e linjës së transportit që do të kalojë nëpër këto fshatra.
Together in Progress	Nga Nënat - Avokim për gratë fermere të komunës së Gjakovës	2,996.00€	Do të krijohen tri fokus grupet me tema: 1) Fuqizimi i ekonomisë blegtorale/bujqësore, 2) Fuqizimi dhe asistimi i grave me ekonomi blegtorale nga ana e institucioneve publike dhe 3) Mundësia e subvencionimit për këto biznese. Në çdo fokus grup do të marrin pjesë	U organizuan tre fokus grupe me temat: 1) Fuqizimi i ekonomisë blegtorale/bujqësore, 2) Fuqizimi dhe asistimi i grave me ekonomi blegtorale nga ana e institucioneve publike dhe 3) Mundësia e subvencionimit për këto biznese, ku morrën pjesë gratë përfituese të projektit, përfaqësues nga shoqëria civile, zyrtarë ku bashkëpunuan për të dhënë rekomandime se si të u'a sigurojnë grave fermere hapësirën për shtijen e prodhimeve të tyre. U realizua

			gratë përfituese të projektit, përfaqësues nga shoqëria civile, zyrtarët nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zvillimit dhe Drejtoria e Bujqësisë, si dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës. Pas publikimit të raportit (të gjeturave nga fokus grupet) do të organizohen dy takime me Drejtorinë e Ekonomisë dhe Drejtorinë e Bujqësisë, për të biseduar rreth rezultateve nga fokus grupet, si dhe ndikimin e fokus grupeve në ndryshimin e politikave për gratë fermere.	kërkesa e grave fermere për shfrytëzimin e hapësirës 'Namasgjah' pa pagesë ose si një shumë e vogël simbolike.
--	--	--	---	---

Iniciativa për Integrim të Komuniteteve	Përmirësimi i pozitës së vajzave dhe grave përmes përfshirjes së tyre në vendim-marrje në Komunën e Dragashit	2,535.00€	Do të organizohen dy trajnime me 40 gra dhe vajza nga Komuna e Dragashit me temat si aktivizmi qytetarë, avokimi dhe mënyrat e identifikimit, adresimit dhe avokimit për çështje specifike. Pas trajnimit do të mbahen takimet për identifikimin e së paku dy çështjeve të rëndësishme për të cilat do të organizojnë tryezë të rrumbullakët për avokim tek përfaqësues të institucioneve lokale në këtë komunë.	33 gra u informuan lidhur me të drejtat e trashëgimisë, pronës dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në proceset politike siç është vendim-marrja. Krahas kësaj, u punësuan 4 gra që kishin aplikuar si këshilltare komunale në Komunën e Dragashit.
Lulishtja	Promovimi i të drejtave të grave dhe fuqizimi i rolit të tyre në	2,757.50€	Do të organizohen takime informuese për gra dhe vajza nga fshatrat: Dabishec, Hajkobillë,	215 gra dhe 5 burra nga 20 fshatrat e komunës së Prishtinës dhe Podujevës u informuan në lidhje me të drejtat e tyre mbi pronën dhe trashëgiminë. Poashtu,

	trashëgiminë pronësore		Gllgovicë, Marec dhe Dumosh të Komunës së Prishtinës dhe atë të Podujevës. Në këto takime, pjesëmarrëset do të informohen në lidhje me të drejtat e tyre mbi pronë dhe trashëgimi. Po ashtu, grave të cilat do të jenë të interesuara për të regjistruar pronën në emrin e tyre, do të ju ndihmohet rreth informimit në lidhje me procedurat të cilat duhen ndjekur.	u ofrua asistencë ligjore për gratë që kishin nevojë për informacione më të detajuara.
OJQ Bliri	Ngritja e vetëdijes së shëndetit riprodaktiv tek të rinjtë	2,985.00€	Do të organizohen takime informuese për 400 nxënës të shkollave të mesme mbi temat si: Kujdesi shëndetësorë, Preventivat e sëmundjeve	400 nxënës të shkollave të mesme u informuar mbi temat si: Kujdesi shëndetësorë, preventivat e sëmundjeve seksualisht të transmetuese, si dhe për Sëmundjet apo dukuritë e shekullit si SIDA, droga dhe duhanpirja. Janë

			seksualisht të transmetuese, si dhe për Sëmundjet apo dukuritë e shekullit si SIDA, droga dhe duhanpirja. Përveç këtyre, do të organizohen edhe takimet informuese me gra dhe vajza në lidhje me sëmundjet si kanceri i gjirit dhe ai i qafës së mitrës. Gjithashtu, Bliri do të organizojë edhe takime avokuese me pjesëmarrëset e projektit, si dhe institucione lokale shëndetësore, ku do të avokojnë për ofrimin e vizitave dhe shërbimeve gjinekologjike pa pagesë.	mbajtur sesione informuese me 400 gra për sëmundje të tilla si: kanceri i gjirit dhe qafës së mitrës. Është avokuar me sukses tek institucionet shëndetësore duke i'u mundësuar vizita dhe shërbime falas gjinekologjike. 15 gra, përmes kësaj iniciative kanë kryer shërbime gjinekologjike pa pagesë.
Gruaja Hynore	Ngritja e vetëdijes së qytetarëve mbi	2,530.00€	Do të organizohen takime informuese për gra dhe vajza nga fshatrat:	Janë organizuar tetë punëtori të ndryshme që përfshijnë gratë dhe vajzat

	të drejtën e grave në pronë dhe trashëgimi		Bresalcë, Velekincë dhe Malishevë të Komunës së Gjilanit. Në këto takime, pjesëmarrëset do të informohen në lidhje me të drejtat e tyre mbi pronë dhe trashëgimi. Po ashtu, pas çdo përfundimi të seancave informative, përfitueseve të projektit do t'ju ipen kontaktet e ligjërueses/juristes me qëllim të asistimit të tyre në realizimin e të drejtës së tyre në pronë dhe trashëgimi.	e moshës 25-55 vjeçare, që për qëllim kanë rritjen e njohurive të pjesëmarrësve për ligjet vendore që garantojnë barazinë gjinore, me fokus të veçantë rëndësinë e trashëgimisë dhe të drejtën në pronë, duke përfshirë legjislacionin e pronës dhe trashëgimisë. Përveç kësaj, kishte edhe grupe punuese në fshatrat Breslac, Velekinke dhe Malisheve. Për të siguruar që rekomandimet e dala nga këto punëtori do të zbatohen, në kuadër të këtij projekti janë organizuar edhe takime avokuese me përfaqësuesit e Komunës së Gjilanit, Zyrës për Barazi Gjinore dhe Drejtorisë për Regjistrim dhe Kadastër nga e njëjta komunë.
Klubi Social Jeto	Qasje më e lehtë e grave në drejtësi për mosmarrëveshje	2,222.00€	Do të organizohen 12 takime vetëdijësuese me 150 gra dhe vajza në komunat e Gjakovës, Junikut dhe Deçanit. Në	U organizuan 13 prezantime në komunitete dhe shkolla të ndryshme nga rajonet e Deçanit, Junikut, Gjakovës dhe Prishtinës. U zhvilluan disa fushata ndërgjegjësuere, tryeza të

	apo konteste pronësore		këto tri komuna, do të realizohen nga katër seanca edukative për vetëdijesimin e grave dhe vajzave të këtyre komunave lidhur me qasjen e tyre në drejtësi, më saktë mekanizmin e ndërmjetësimit. Gjithashtu, do të realizohen 3 takime me Qendrat për Punë Sociale të këtyre tri komunave, në mënyrë që të identifikohen rastet në të cilat janë të përfshira gratë dhe të cilat kanë mundësi ta përdorin procedurën e ndërmjetësimit për	rrumbullakëta, trajnime dhe seminare ku për qëllim kishin promovimin e të drejtave të njeriut, rritjen e pjesëmarrjes në jetën shoqërore dhe ekonomike për të gjitha grupmoshat. Gjithësej, 129 pjesëmarrës përfituan nga ky projekt, 113 gra dhe 16 burra. Njëheri u avokua tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe tek Qendrat për Punë Sociale në komunat e Junikut, Deçanit dhe Gjakovës. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve u informuan për rëndësinë e ndërmjetësimit në mënyrë që gratë dhe vajzat të kenë mundësi të shprehin vullnetin e tyre, të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre, të jenë në gjendje të jenë të barabartë me palën tjetër si pjesë e procedurës dhe të jenë të informuara për punën e zyreve të ndërmjetësimit në 7 rajonet e Kosovës.
--	------------------------	--	--	--

			zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo kontesteve në rastet e tyre pronësore. Poashtu, pjesëmarrëset do të informohen në lidhje me ofrimin e asistencës në realizimin e të drejtës së tyre në pronë dhe trashëgimi nga ana e menaxheres së projektit e cila është ndërmjetësuese e licencuar.	
			Do të organizohen 8 ligjërata me 100 anëtarë të kësaj organizate në lidhje me temën “Qasja e grave/vajzave me aftësi të kufizuar në kujdesin shëndetësor”. Poashtu,	Janë organizuar 8 takime informuese, me 98 anëtarë të kësaj organizate në lidhje me të drejtat e tyre për kujdesin shëndetësor. Gjithashtu u organizuan 10 sesione individuale midis përfituesve dhe

Handikos Mitrovica	Qasja e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në kujdesin shëndetësor	3,531.25€	do të organizohen 10 sesione individuale në mes përfituesve nga ligjëratat dhe daktreshës, ku do të ofrohen shërbime mjekësore të nevojshme për shëndetin riprodhues dhe amësor, sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, do të organizohen takime avokuese me pjesëmarrëset e projektit, si dhe institucionet lokale shëndetësore, ku do të avokojnë për ofrimin e vizitave dhe shërbimeve shëndetësore më të mira për personat me nevoja të veçanta.	mjekut, ku morën udhëzime mjekësore sipas disa çështjeve shëndetësore. Po ashtu, janë organizuar takime avokuese me përfituesit e projektit dhe institucionet shëndetësore lokale, ku avokuan për ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara
--------------------	--	-----------	---	--

Qendra e Kosovës për Zhvillim dhe Integrim Multikulturor	Fuqizimi ekonomik i të rinjve nga komunitetet jo-shumicë: Rom, Ashkali, Egjiptian, me fokus tek vajzat	3,705.00€	Do të identifikojnë rreth 50 studentë të diplomuar të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas për të cilët do të organizohen trajnimet në lidhje me temat: Shkrimi i CV, Paraqitja fizike intelektuale dhe Gatishmëria e takimet me punëdhënësin. Përveç këtyre trajnimeve, për përfituesit do të organizohen edhe kurse të gjuhës angleze, kurse për kompjuterët, si dhe kurse për oratori. Gjithashtu, stafi i organizatës, së bashku me përfituesit, do të avokojnë tek institucionet lokale në Komunën e	Janë identifikuar 29 të rinj romë dhe egjiptian të cilët kishin diplomuar në universitet, por ishin të papunë. 29 të rinjëve i'u është ofruar mundësia për të ndjekur kurse të ndryshme si: kurse kompjuterike, kurse te gjuhës angleze dhe kurse për aftësimin e të folurit.
--	--	-----------	--	---

			Gjakovës për ofrimin e mundësive për kryerjen e praktikës në këto institucione si kriter kyç për punësimin e tyre.	
Girls Coding Kosova	"#EcShlirë v.3.0. – Bashkëpunimi me policinë e Kosovës"	4,000.00€	Do të lidhin marrëveshje me Policinë e Kosovës për raportimin e ngacmimeve seksuale përmes aplikacionit #EcShlirë, ku platformën e këtij aplikacioni do ta instalojnë në stacionin kryesor të Policisë së Kosovës. Poashtu, kjo organizatë do ta trajnojë stafin e Policisë të Kosovës për përdorimin e këtij aplikacioni dhe të dhënat e ngacmimeve të cilat raportohen përmes tij.	U trajnuan 6 policë të Kosovës, 6 zyrtarë nga Komuna e Prishtinës dhe një zyrtar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Kosovës për përdorimin e aplikacionit dhe të dhënat e ngacmimeve që do të raportohen përmes tij. Është lidhur marrëveshja me Policinë e Kosovës për të përdorur raportet e dalura nga ky aplikacion për të hetuar ngacmimet seksuale dhe për të përmisuar sigurinë. Më tej, 26,500 njerëz u ndërgjegjësuam rreth ngacmimit seksual nëpërmjet lancimit të një video në media.

Education Code	Gratë sipërmarrëse	3,642.00€	Do të mbajnë trajnime me gratë udhëheqëse të bizneseve të vogla nga komunat e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës, në temat: Krijimi dhe zhvillimi i mikrobizneseve, Problematikat e grave në biznes dhe tejkalimi i tyre, dhe Ndikimi i çështjes pronësore në veprimtaritë biznesore të grave. Përveç trajnimeve, stafi i kësaj organizate do të organizojë vizita, si dhe sesione mentoruese dhe konsulenca për gratë në biznes. Gjithashtu, "Education Code" do të avokojë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që të	36 gra udhëheqëse të bizneseve të vogla mbajtën trajnime mbi temat: Krijimi dhe zhvillimi i mikrobizneseve, Problematikat e grave në biznes dhe tejkalimi i tyre, dhe Ndikimi i çështjes pronësore në veprimtaritë biznesore të grave. Krahas kësaj, u organizuan vizita dhe sesione këshilluese për të mbështetur përfituesit me bizneset e tyre. U avokua me sukses tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, duke nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi për të rritur numrin e trjaneve, mentorimeve dhe përkrahjen e bizneseve të këtyre grave. Poashtu, u nënshkrua dhe një Memorandum Mirëkuptimi me MBPZHR-në, për të organizuar sesione informuese dhe këshilluese në komunat e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës, para skemave të granteve dhe subvencioneve, në mënyrë që gratë sipërmarrëse nga komunat target të
----------------	--------------------	-----------	--	--

			risë numrin e trajnimeve, monitorimeve dhe mbështetjes për bizneset e këtyre grave, si dhe do të kërkojë nga MBPZHR-ja të organizojë sesione informuese dhe këshilluese në komunat e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Gracanicës, para skemave të granteve dhe subvencioneve, në mënyrë që gratë sipërmarrëse nga komunat target të kenë mundësi të informohen në lidhje me mënyrat e zhvillimit të mëtutjeshëm të bizneseve bujqësore dhe artizanale.	kenë mundësi të informohen në lidhje me mënyrat e zhvillimit të mëtutjeshëm të bizneseve bujqësore dhe artizanale.
--	--	--	--	---

Instituti i Psikologjisë Aplikative, Alpha	Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe grave të burgosura në Kosovë përmes socializmit të tyre (II)	3,845.00€	Do të mbajë trajnime me gra të burgosura në burgun e Lipjanit në temat: Ndjenja e fajit, Teknikat dhe mënyrat e largimit të brengosjes, Ngritja e vetëbesimit, Falja dhe njohja, Ndryshimi pozitiv i sjelljes tonë dhe njerëzit rreth nesh. Përveç trajnimeve për të burgosurat, stafi i Institutit Alpha do të punojë edhe me stafin e Institucionit Korrektues të Lipjanit, si dhe do të avokojë për ofrimin e më shumë mënyrave të punës dhe aktiviteteve rekreative për të burgosurat.	15 gra të burgosura në Institucionin Korrektues të Lipjanit u trajnuan mbi temat: ndjenjat e fajit, teknikat dhe mënyrat e eliminimit të shqetësimeve, rritja e vetëbesimit, falja dhe pranimi etj. Njëheri, është punuar me 15 punonjës të Institucionit Korrektues në Lipjan dhe kanë avokuar për ofrimin e më shumë mundësive të punës dhe aktiviteteve rekreative për të burgosurat.
--	--	-----------	--	--

Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes	Një grua e edukuar, një shoqëri e shëndoshë	3,815.00€	Do të zhvillohen 12 punëtori me gra dhe vajza nga Komuna e Gjakovës, në lidhje me vetëdijesimin e tyre mbi të drejtat dhe rëndësinë e kujdesit shëndetësorë. Gjatë realizimit të kësaj iniciative, do të realizohet edhe pyetësori me rreth 400 vajza të reja në lidhje me njohurinë e tyre mbi shëndetin. Poashtu, do të organizohen edhe vizitat gjinekologjike pa pagesë për gratë dhe vajzat e kyçura në këtë projekt. SHEPF-ja do të avokojë edhe tek Drejtoria e Shëndetësisë për hapjen e zyrës gjinekologjike për vajza të reja.	U zhvilluan 12 punëtori me 230 gra dhe vajza nga Komuna e Gjakovës si dhe u zhvilluan pyetësor me këto gra dhe vajza lidhur me ndërgjegjësimin e tyre për të drejtat dhe rëndësinë e kujdesit shëndetësor. 22 gra dhe vajza kryen vizita gjinekologjike pa pagesë. Më tej, u avokua tek Drejtoria e Shëndetësisë në Gjakovë për hapjen e zyrës gjinekologjike për vajzat e reja.
--	---	-----------	--	--

Rikotta & Shoqata e Grave "Gora"	Vetëdijesohu, shëndeti juaj është i rëndësishëm për shoqërinë	5,958.00€	Do të mbahen dy trajnime pesë ditore për rreth 50 përfituese të projektit nga ana e gjinekologes dhe onkologes. Gjatë këtyre trajnimeve, do të shtjellohen temat si: Infeksionet seksuale të transmetueshme, Metodot bashkëkohore të planifikimit familjarë, HIV/AIDS, Përdormi i mjeteve kontraceptive, Shërbimet shëndetësore të ofruara në QMF-të në këtë rast në Prizren, si dhe Sëmundjet malinje – kanceri i gjirit dhe i cerviksit. Do të avokohet tek Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria	U informuan 120 goranë, torbesh dhe gra serbe nga komuna e Prevallicit mbi temat: infeksionet seksuale të transmetueshme, metodat bashkëkohore të planifikimit familjarë, HIV/AIDS, përdormi i mjeteve kontraceptive, shërbimet shëndetësore të ofruara në QMF-të në këtë rast në Prizren, si dhe sëmundjet malinje – kanceri i gjirit dhe i cerviksit. U avokua me sukses tek Komuna e Prevallës, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Shëndetësisë në Prizren dhe tek Instituti i Shëndetit Publik, ku i'u mundësua grave të kenë vizita gjinekologjike dhe kontrolla të ndryshme falas në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Reçan
----------------------------------	---	-----------	---	--

			për Shëndetësi në Kuvendin Komunal të Prizrenit, si dhe tek Instituti i Shëndetit Publik, ku do të ju mundësohet grave në nevojë që të lirohen nga pagesat dhe participimi për kontrole të ndryshme si Pap testi e mamografia, si dhe t'iu sigurohet një dhomë me paisje gjinekologjike në QMF në Reçan dhe një gjinekologe.	
Naš Dom & Qendra e Grave për Zhvillim Rural	Përmirësimi i politikave lokale nga perspektiva e grave	7,980.50€	Do të mbahen trajnimet e rreth 30 grave të komuniteteve shqiptare dhe serbe nga komunat e Gjilanit, Novobërdës dhe Kamenicës në temat si: Ngritja e vetëdijes së grave mbi rëndësinë e	31 gra nga komunitetet shqiptare dhe serb u trajnuan mbi temat si: ngritja e vetëdijes së grave mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse, si dhe krijimi i marrëdhënieve dhe komunikimit më të mirë në mes të bartësve të së drejtave dhe ushtruesve. Më tej, u formua trupi

			pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse, si dhe Krijimi i marrëdhënieve dhe komunikimit më të mirë në mes të bartësve të së drejtave dhe ushtruesve. Përveç trajnimeve, do të formohet trupi joformal ndërkomunal i cili do krijojë dokumentin punues me prioritet të grave nga këto tri komuna. Përmes këtij dokumenti, grupi joformal do të avokoj tek institucionet lokale për miratimin e rekomandimeve nga ky dokument.	joformal ndërkomunal i cili krijojë dokumentin punues me prioritet të grave nga këto tri komuna, Gjilan, Novobërdë dhe Kamenicë. Përmes këtij dokumenti, grupi joformal avokoi tek institucionet lokale për miratimin e rekomandimeve nga ky dokument
Dera e Hapur & Ruka Ruci	Fuqizimi i Grave aktiviste nga	7,955.00€	Do të mbahen trajnimet me rreth 20 përfituese të	

	komuniteti për të çuar përpara të drejtat e grave dhe barazinë gjinore përmes pjesëmarrjes, informative dhe mediave sociale		komunitetit shqiptarë dhe serb nga fshatrat Dobrotin, Uglarë, Laplja Sellë, Graçanicë, Hajvali, Bardhosh dhe Slivovë mbi temat si: Përdorimi i internetit, Ndarja e tregimeve, Nxjerrja në pah e çështjeve, Propozimi i zgjidhjeve, Gratë dhe siguria sociale, Vetëkujdesi dhe privatësia e nevojshme, Aktivizmi në internet dhe përdorimi i mediave sociale. Përveç këtyre, do të mbahen trajnimet mbi ngritjen e vetëdijes rreth mekanizmave lokal dhe procesin e kyçjes së tyre në proceset	U trajnuan 22 gra shqiptare dhe serbe mbi temat si: përdorimi i internetit, ndarja e tregimeve, nxjerrja në pah e çështjeve, propozimi i zgjidhjeve, gratë dhe siguria sociale, vetëkujdesi dhe privatësia e nevojshme, aktivizmi në internet dhe përdorimi i mediave sociale. Më tej, 400 gra morën pjesë në dy punëtori, ku u informuan se si gratë mund të jenë më aktive në proceset e vendim-marrjes, duke ngritur zërin përmes iniciativave të ndryshme vetëdijesuese.
--	---	--	--	--

			vendimmarrëse, si dhe ndarjen e përvojave.	
--	--	--	---	--

Shtojca 2. Të arriturat e avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2017

Grupi i Lobit	Iniciativat avokuese	Rezultatet e arritura	Politikat e ndryshuara	# i iniciativave avokuese
Gjilan	1) Kanë avokuar për përkahje për gratë lidhur me pjesëmarrjen e tyre në politkë dhe vendimmarrje, ku tani Gjilani përfaqësohet nga 5 gra deputete në nivel qendror (e arritur). 2) Kanë avokuar tek Departamenti Komunal i Arsimit për ndryshime në kurrikulë, duke kërkuar integrimin e	2	0	3

	temave që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. 3) Ngritja e vetëdijes së grave dhe vajzave për të drejtën në pronë dhe trashëgimi, ku kanë mbajtur rreth 20 trajnime mbi këtë temë për rreth 150 gra. Ndërkaq, 12 gra kanë inicuar procedurat për regjistrimin e pronës në emër të tyre (e arritur).			
Istog	1) 60 gra e vajza kanë marrë pjesë në takime vetëdijësuese mbi temën e të drejtave në pronë dhe trashëgimi, që janë mbajtur në zona rurale (e arritur). 2) Është arritur të shtohen 5 bursa komunale për studime për vajzat (e arritur).	2	0	2
Mamushë	1) Iniciativa avokuese për paisjen e qytetarëve me letërnjoftime në dy gjuhë zyrtare: në gjuhën shqipe dhe turke (e arritur).	1	0	1

Kamenicë	1) Kanë ndihmuar financiarisht gratë e diagnostifikuara me kancer, ku komuna ka nda nga 110€ për 100 gra (e arritur). 2) Kanë ndarë pako higjienike në vlerë prej 55€ për rreth 50 nëna vetushqyese (e arritur). 3) Kanë organizuar rreth 25 ligjërata në vende rurale mbi shëndetin dhe për parandalimin e dhunës në familje. Gjatë këtyre ligjëratave, është bërë edhe identifikimi i grave që vuajnë nga kanceri, me ç'rast mjekët më pas kanë vazhduar kontaktin me këto gra për mjekimin e tyre (e arritur). 4) Kanë përkrahur 2 gra për zhvillimin e bizneseve, me ç'rast njërës i është zbritur shuma e qirasë e tjetra është liruar nga qiraja e objektit i cili ka qenë objekt i komunës (e arritur).	5	0	5
----------	--	---	---	---



Vushtrri	1) Kanë formuar Grupin e të Rinjëve Vullnetarë, me 15 vajza e djem, për përkrahje të punës së Lobit në Komunën e Vushtrrisë (e arritur). 2) Kanë avokuar në QKMF për realizimin e kontrollave mamografike për gratë kryefamiljare, me ç'rast 40 gra i kryen këto kontrolla (e arritur).	2	0	2
Deçan	1) Kanë organizuar 4 takime me nga rreth 20 gra në zona rurale për të identifikuar problematikat me të cilat përballen ato në jetën e përditshme, si papunësia, dhuna në familje, mungesa e barazisë gjinore, prona dhe trashëgimia etj.	0	0	1
Podujevë	1) Po avokojnë tek Komuna që të ndajnë pagesa për gratë lehona. 2) Po avokojnë tek Komuna që të lirojnë nënat vetushqyese nga pagesa për fëmijët në instiucionet parashkollore.	0	0	2

Shtime	1) Kanë organizuar dy takime, ku morrën pjesë rreth 60 gra, mbi temat: përkrahja e grave në biznes dhe të drejtat mbi pronën dhe trashëgimianë, ku si rezultat, është arritur fuqizimi ekonomik i 1 gruaje që ka hapur biznesin e saj, si dhe 1 grua e divorcuar ka inicuar rastin për kërkimin e trashëgimisë nga familja e saj e origjinës (e arritur). 2) Kanë avokuar për lehtësira në taksa për gratë që hapin biznese të reja, gjë e cila tash është e garantuar me ligj (e arritur).	2	0	2
Malishevë	1) Kanë avokuar për sigurimin e një mamografi, por edhe pse nuk u sigurua, u arrit që të vij mamografi mobil në komunë, me ç'rast 300 gra kanë kryer kontrolle (e arritur). 2) Janë punësuar 4 gra kryefamiljare, më ç'rast njëra në postin e drejtores së shkollës (e arritur).	3	0	4

	3) 20 gra janë çertifikuar për konzervimin e perimeve, nga një organizatë që ka ofruar trajnime në këtë fushë (e arritur). 4) Kanë avokuar për rritjen e përkrahjes për gratë dhe vajzat, me ç'rast më shumë gra kanë përfituar subvencione nga komuna në bujqësi dhe bursa për studime.			
Pejë	Kanë mbajtur 10 takime vetëdijësuese me gra për të drejtat në pronë dhe trashëgimi (9 në fshatra e 1 në qytetin e Pejës), ku kanë marrë pjesë rreth 100 gra (e arritur).	1	1	1
Lipjan	Po avokojnë për krijimin e një kodi buxhetor për Zyrën për Barazi Gjinore brenda Komunës.	0	1	1
Mitrovicë	Kanë avokuar për përkrahjen e grave që kanë qenë në listat zgjedhore në zgjedhjet e fundit komunale, përfshirë edhe të kandidatet së vetme për Kryetare të Komunës – Valdete Idrizi.	0	0	1

Viti	1) Po avokojnë për fillimin e zbatimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinnor në institucionin e komunës. 2) Kanë përkrahur ekonomikisht gratë, me ç'rast janë hapur 10 biznese të reja dhe janë formuar 5 OJQ të grave (e arritur). 3) Nën vetushqyese janë liruar nga pagesa për fëmijët në çerdhet publike (e arritur). 4) Po avokohet për sigurimin e pagesave në shumë prej 100€ për lehonat që janë pjesë e skemës sociale. 5) Kanë avokuar për lehtësira në taksa për gratë që hapin biznese të reja, gjë e cila tash është e garantuar me ligj (e arritur).	3	0	5
Skënderaj	1) Janë ndarë 66 bursa për studentë me kushte të rënda ekonomike (e arritur). 2) Janë vendosur në banesa sociale 3 gra viktime të dhunës në familje (e arritur).	6	1	6



	3) 42 fermerë janë certifikuar nga organizata IADK (e arritur). 4) 81 gra kanë regjistruar pronën në emër të tyre e 11 të tjera në bashkëpronësi (e arritur). 5) Janë organizuar 2 panaire (e arritur). 6) Janë punësuar 7 gra, 3 prej tyre në Komunë e 4 në kuzhina të shkollave të ndryshme (e arritur).			
Prizren	Iniciativa avokuese për hapjen e çerdhes publike në Prizren, që ka qenë shumë e nevojshme për të plotësuar nevojat e nanave që punojnë në këtë komunë (e arritur).	1	0	1
Fushë Kosovë	1) Kanë organizuar trajnim për të drejtat në pronë dhe trashëgimi në Kamenicë, Drenas, Fushë Kosovë, Slatinë dhe Vushtri, ku kanë marrë pjesë rreth 100 vajza dhe gra (e arritur).	2	1	3

	2) Kanë ndarë 11 pako ndihma për familjet në nevojë në Fushë Kosovë, ku familjet janë përzgjedhur duke u bazuar në të dhënat e QPS-së (e arritur). 3) 3 gra janë informuar dhe orientuar që të ndjekin një trajnim me mundësi punësimi, që ofrohej nga organizata SHE-ERA.			
Suharekë	1) 6 gra kanë marrë pjesë në tryeza diskutimi të organizuara nga KDI gjatë kohës së zgjedhjeve komunale, lidhur me temën e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje. 2) Janë organizuar diskutime me akterët përgjegjës në nivel komunal mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator. 3) Në zgjedhjet e fundit komunale është rritë numri i grave të përzgjedhura si asambleiste, ku sivejt janë 10 gra e prej	3	0	5

	tyre 8 janë përzgjedhur pa ndikimin e kuotës (e arritur). 4) Me fondet që ishin paraparë për dhurata me rastin e 8 marsit në institucionin e komunës, janë siguruar 10 bursa shtesë për vajzat studente të komunës tone (e arritur). 5) Është blerë mamografi mobil (e arritur).			
Kllokot	1) Vetëdijësimi i grave mbi të drejtat e tyre në pronë dhe trashëgimi përmes organizimit të 4 takimeve ku morrën pjesë rreth 100 persona (e arritur). 2) Vazhdimisht është përkrahur klasa e fëmijëve me nevoja të veçanta, ku vijnë mësimin 12 fëmijë, të cilëve iu janë dhuruar mjete shkollore, dhurata të tjera, pastaj është organizuar drekë për ta me rastin e 28 nëntorit etj (e arritur). 3) Në nivel komunal janë ofruar trajnime disa ditore për gratë, mbi tema të	4	1	4

	ndryshme, si përdorimi i internetit, marketingu përmes rrjeteve sociale etj. ku kanë marrë pjesë rreth 208 gra (e arritur). 4) Janë përkrahur rreth 8 OJQ të grave në shkrimin e projekt – propozimeve (e arritur).			
Novobërdë	1) Është hapur Shtëpia e Sigurtë (strehimorja) për gratë dhe fëmijët që janë viktimë të dhunës në familje, ku inventari është siguruar nga KFOR-I (e arritur). 2) Në një fshat të komunës janë siguruar orë mësimore shtesë për fëmijët e komunitetit Romë, me ç'rast për këtë është punësuar edhe një vajzë e këtij komuniteti (e arritur). 3) Organizata ndërkombëtare IOM ka përkrahur projektin e 2 organizatave të grave që ka për qëllim përkrahjen e të	4	0	4

	moshuarve që jetojnë vetëm. Përmes këtij projekti në total janë punësuar 3 gra nga komuniteti shqiptarë, serb dhe romë, të cilat do të përkujdesen për këta të moshuar (e arritur). 4) Janë punësuar 2 gra dhe 1 burrë në Drejtorinë e Bujqësisë, me përkrahje të projektit Resi (e arritur).			
Drenas	1) Rreth 170 gra kanë kryer vizita gjinekologjike falas (e arritur). 2) Është avokuar tek drejtoritë komunale përkatëse për fuqizimin ekonomik të grave, me ç'rast më shumë gra kanë aplikuar për përfitimin e granteve, serave etj komunale, dhe si rrjedhojë më shumë gra kanë përfituar. 3) Është rritur numri i grave pjesëmarrëse në politikë dhe vendimmarrje, me ç'rast tani kemi 5 gra udhëheqëse te drejtorive	2	0	3

	komunale she 5 gra drejtore të shkollave (e arritur).			
Dragash	1) Komuna ka përkrahur 5 gra kryefamiljare, me nga 100 € (e arritur). 2) Iniciativa avokuese për ndërtimin e një çerdheje publike që ka munguar në këtë komunë, ndërkaq ajo pritet të fillojë punën së shpejti (e arritur). 3) Janë siguruar linja të rregullta të udhëtimit me autobus në relacionin Dragash-Prizren-Dragash (e arritur).	3	1	3
Gjakovë	1) Iniciativa avokuese për amandamentimin e Ligjit për taksat ekologjike, që është në proces ende. 2) Kanë avokuar për çështjen e shkollimit jo-formal dhe për njohjen e diplomave të fituara nga ky lloj shkollimi (e arritur).	1	1	2
Ferizaj	1) Kanë avokuar me sukses që çdo grua që lind fëmijë, të përfitojë nga 100 € për lindje (e arritur).	4	0	4

	2) Kanë përkrahur 120 familje skamnore me pako ushqimore e higjienike, si dhe veshmbathje (e arritur). 3) Kanë avokuar që femrat me aftësi të kufizuara dhe nënat vet-ushqyese të përfitojnë nga ndarja e banesave sociale, ku përfituan 4 familje (e arritur). 4) Kanë arritur të heqin shpenzimet mortore për të gjithë qytetarët e komunës (e arritur).			
Obiliq	1) Janë përkrahur 4 nëna vetushqyese me subvcencione (e arritur). 2) Janë përkrahur financiarisht 2 nëna vetushqyese për trajtim mjekësor (e arritur).	2	0	2
Junik	1) Iniciativa avokuese për përkrahjen e grave dhe fuqizimin e tyre ekonomik. 2) Iniciativa avokuese për hapjen e një qendre për shitjen e ushqimeve tradicionale të pregaditura nga gratë.	0	0	3

3) Iniciativa avokuese për punësimin e më shumë grave në institucionin e Komunës.			
---	--	--	--



Rrjeti i Grave të Kosovës
Rr. Kadri Gjata (ish Feriz Blakçori), kati II, nr. 8
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 245 850
www.womensnetwork.org
info@womensnetwork.org
Facebook: Kosova Women's Network

 **KVINNA**
KVINNA

